



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 224

Tiranë – E mërkurë, 3 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 26.11.2025	Për miratimin e Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar, në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030 dhe të planit të veprimit.....	28023
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 179, datë 19.11.2025	Për delegim kompetence.....	28065
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1245, datë 21.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	28066
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1246, datë 21.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës.....	28067
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1247, datë 21.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	28068
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 72, datë 17.11.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Prishjen/shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit.....	28069
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 795, datë 18.11.2025	Për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit.....	28072

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 285, datë 13.11.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	28077
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 286, datë 13.11.2025	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	28078
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 287, datë 13.11.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	28079
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 13.11.2025	Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyra 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Klisyrë’, me kapacitet prodhues 2 mw”	28082
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 289, datë 13.11.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	28084
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 292, datë 13.11.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”.....	28086
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 293, datë 13.11.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2025, “Mbi miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestionëve”.....	28087
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 295, datë 17.11.2025	Mbi shqyrtimin e kërkesave të shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit, me fuqi të instaluar mbi 11 kw”.....	28088
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 296, datë 17.11.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘M.C Energji Gojan’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Gojan’”	28090
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 297, datë 17.11.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw”	28091
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 298, datë 17.11.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Koka & Ergi Energy Stavec’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Stavec’, me kapacitet të instaluar 6250 kw”	28092
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 299, datë 17.11.2025	Mbi miratimin e “Strategjisë së ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative, 2025–2030”	28094

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 300, datë 17.11.2025	Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.....	28100
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 301, datë 17.11.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	28102
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 302, datë 17.11.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	28104
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 303, datë 17.11.2025	Mbi dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Klos Torrent Works” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a.....	28106
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 304, datë 17.11.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k.....	28108

**VENDIM****Nr. 710, datë 26.11.2025****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
PËR MODERNIZIMIN DHE
HARMONIZIMIN E SISTEMEVE TË
INFORMACIONIT DOGANOR
SHQIPTAR, NË PËRPTHJE ME
SISTEMET E INFORMACIONIT
DOGANOR TË BASHKIMIT EVROPIAN,
PËR PERIU DHËN 2025–2030 DHE TË
PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar, në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030 dhe të planit të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**STRATEGJIA PËR MODERNIZIMIN DHE
HARMONIZIMIN E SISTEMEVE TË
INFORMACIONIT DOGANOR SHQIPTAR,
NË PËRPTHJE ME SISTEMET E
BASHKIMIT EVROPIAN PËR PERIU DHËN
2025–2030 DHE PLANI I VEPRIMIT**

Përmbajtja

KAPITULLI I: HYRJE

- 1.1 Qëllimi i strategjisë
- 1.2 Konteksti i Integritimit Evropian
- 1.3 Sfidat e modernizimit
- 1.4 Përfitimet strategjike
- 1.5 Korniza strategjike dhe ligjore

1.6 Misioni dhe vizioni

KAPITULLI II: ANALIZA E SITUATËS

- 2.1 Gjendja aktuale e sistemit doganor shqiptar
- 2.2 Mangësitë kryesore të identifikuara
 - a) Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit
 - b) Korniza ligjore dhe rregullatore
 - c) Burimet njerëzore
 - d) Bashkëpunimi ndërinstitucional
- 2.3 Niveli i digjitalizimit të proceseve doganore
- 2.4 Lidhja me sistemet e BE-së
- 2.5 Sfidat e transformimit digjital
- 2.6 Justifikimi për reformën
- 2.7 Përfundimi i analizës

KAPITULLI III: OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

- 3.1 Qëllimi i përgjithshëm
 - 3.2 Objektivat specifike dhe shtyllat strategjike
 - 3.2.1 Shtylla 1: Zhvillimi i një sistemi doganor digjital, të integruar dhe koherent
 - 3.2.2 Shtylla 2: Modernizimi i administratës doganore dhe digjitalizimi i proceseve të brendshme
 - 3.2.3 Shtylla 3: Mbështetja e digjitalizimit të proceseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)
 - 3.2.4 Shtylla 4: Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK-ut në dogana
 - 3.2.5 Shtylla 5: Përmirësimi i aftësive teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar
- Përfitimet e synuara nga realizimi i objektivave të strategjisë

KAPITULLI IV: SISTEMET QË DO TË ZBATOHEN

- 4.1 Sistemi i Shkëmbimit të Certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së (EU CSW - CERTEX)
- 4.2 Sistemi i Importit të Mallrave Kulturore (sistemi ICG)
- 4.3 Sistemi i Kontrollit të Importit të UCC 2 (ICS2)
- 4.4 Sistemi i Menaxhimit të Riskut Doganor (CRMS2)
- 4.5 Sistemi i Vendimeve Doganore të UCC (CDS)
- 4.6 Sistemi Uniform i Menaxhimit të Përdoruesit & Nënshkrimit Digjital (UUM&DS)
- 4.7 Sistemi i Eksportuesve të Regjistruar të UCC (REX)
- 4.8 Informacioni i Detyrueshëm Tarifor Evropian (EBTI)



4.9 Sistemi i Regjistrimit dhe Identifikimit të Operatorit Ekonomik të UCC 2 – EORI2

4.10 Mbikëqyrja e UCC 3 – SURV3

4.11 Fletët e Informacionit të UCC (INF) për Procedurat Speciale

4.12 Operatorët Ekonomikë të Autorizuar të UCC – AEO

4.13 Menaxhimi i Garancisë UCC (GUM)

4.14 Prova e Statusit të Unionit të UCC (PoUS)

4.15 COPIS (IPR *enforcement*)

4.16 Moduli TARIC (*Tarif Integre Communautaire*)

4.17 Moduli TQS (Kuotat Tarifore dhe Mbikëqyrja)

4.18 Moduli SMS (Sistemi i Menaxhimit të Specimeneve)

4.19 Moduli ECICS (Inventari Doganor Evropian i Substancave Kimike)

4.20 NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit)

4.21 Sistemi i Automatizuar i Eksportit (AES)

4.22 Zhdoganimi i Centralizuar i UCC për Import (CCI)

4.23 Njoftimi i Mbërritjes, Njoftimi i Prezantimit dhe Magazinimi i Përkohshëm AN/PN/TS sipas UCC

4.24 Sistemi Kombëtar i Importit të UCC (NIS)

4.25 *Integrated Tariff Management System* (ITMS)

KAPITULLI V: STRATEGJITË E ZBATIMIT DHE KPI-ve (KONTROLLI I PERFORMANCËS SË INDIKATORËVE)

5.1 Masa konkrete të implementimit

5.2 Tabela e treguesve kryesorë të performancës (KPI)

5.3 Procedurat e Raportimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Progresit

KAPITULLI VI: FINANCIMI I STRATEGJISË

KAPITULLI VII: BASHKËPUNIMI RAJONAL

7.1 Rëndësia strategjike e bashkëpunimit rajonal

7.2 Kuadri politik dhe institucional i bashkëpunimit rajonal

7.3 Prioritetet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

a) Harmonizimi i procedurave dhe standardeve

b) Shkëmbimi elektronik i informacionit

c) Krijimi i korridoreve të gjelbra

7.4 Shembuj konkretë të bashkëpunimit rajonal

Shqipëri–Kosovë

Shqipëri–Maqedoni e Veriut

Shqipëri–Mali i Zi

Shqipëri–Greqi–Itali

7.5 Sfida të bashkëpunimit rajonal

7.6 Roli i BE-së dhe organizatave ndërkombëtare

7.7 Përfitimet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

7.8 Përfundim mbi bashkëpunimin rajonal

KAPITULLI VIII: PËRFUNDIME

8.1 Mbyllja e ciklit të reformës dhe rëndësia historike

8.2 Përfitimet institucionale dhe administrative

8.3 Përfitimet ekonomike dhe tregtare

8.4 Përfitimet sociale dhe politike

8.5 Ndikimi në procesin e integritimit evropian

8.6 Sfidat e ardhshme dhe qëndrueshmëria

8.7 Vizioni afatgjatë për Shqipërinë në sistemin doganor evropian

Shtojca 1: Plani i Veprimit të Strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor shqiptar në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030

Shtojca 2: Tabela e Kostimit të Strategjisë

KAPITULLI I

HYRJE

1.1 Qëllimi i Strategjisë

Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor shqiptar, në përputhje me sistemet e Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030, ka si synim themelor zhvillimin e një administrate doganore moderne, të digjitalizuar dhe plotësisht të integruar me rjetet doganore evropiane. Kjo strategji përfaqëson një instrument që do të garantojë efikasitet më të madh në procedurat doganore, rritje të transparencës dhe ulje të kostove administrative për bizneset, si dhe forcim të sigurisë kombëtare nëpërmjet menaxhimit më të mirë të kufijve dhe kontrollit të flukseve tregtare.

Qëllimi përfundimtar është që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një sistem doganor në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit Evropian (*Union Customs Code – UCC*), duke lehtësuar kështu integrimin gradual në tregun e përbashkët evropian dhe duke kontribuar në konsolidimin e procesit të anëtarësimit.

1.2 Konteksti i Integritimit Evropian

Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga vitin 2014. Në vitin 2020



u hapën negociatat për anëtarësim dhe që nga viti 2022 ka nisur procesi i *screening*. Një ndër fushat ku është evidentuar domosdoshmëria për përparim të shpejtë është dogana, e cila lidhet drejtpërdrejt me lëvizjen e lirë të mallrave, si një nga katër liritë themelore të BE-së.

Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar më 8 maj 2025, qëndrimin e përbashkët të BE-së për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, për 8 kapituj të rinj të Grupimit të 3: “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”, duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm përpara në negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Ky grupim përfaqëson rritjen gjithëpërfshirëse për mirëqenie dhe përfshin tetë fusha, mes të cilave edhe kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”.

Në dokumentin e publikuar nga Komisioni Evropian pas përfundimit të Konferencës së Katërt Ndërqeveritare midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë në Bruksel, për kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”, nënvizohet se, BE-ja mirëpret kapacitetin adekuat administrativ dhe operacional të Shqipërisë për të përmbushur detyrat ekzistuese doganore. BE-ja fton Shqipërinë të forcojë më tej ndërtimin e kapaciteteve dhe rekrutimin e stafit përpara anëtarësimit, në veçanti në fushën e Teknologjisë së Informacionit (IT). BE-ja nënvizon nevojën që Shqipëria të vazhdojë të zhvillojë dhe përmirësojë sistemet ekzistuese IT, në përputhje me Planin Shumëvjeçar Strategjik për Doganat Digjitale, për të siguruar përafrimin me sistemet doganore të BE-së dhe për të garantuar ndërveprueshmërinë. BE-ja kujton nevojën që Shqipëria të alokojë burime të mjaftueshme financiare për të gjitha projektet IT në vijim dhe ato të planifikuara.

Në këtë kuadër, përafrimi i infrastrukturës ligjore dhe teknologjike të doganave shqiptare me atë të BE-së nuk është vetëm një kërkesë teknike, por një parakusht politik dhe ekonomik për avancimin e negociatave të anëtarësimit. Bashkimi Evropian e konsideron administratën doganore një element kyç të sigurisë së kufijve të jashtëm dhe të funksionimit të tregut të përbashkët.

1.3 Sfidat e modernizimit

Proceset aktuale të doganave shqiptare, janë të mbështetura dhe realizohen kryesisht në sistemin “ASYCUDA World”, e cila ka mundësuar një shkallë të caktuar digjitalizimi, por ende nuk

garantojnë integrim të plotë me platformat evropiane. Kjo situatë sjell disa sfida madhore:

- procedura të gjata dhe burokratike;
- mungesë ndërveprimi në kohë reale me autoritetet doganore të BE-së;
- nivel të ulët sigurie kibernetike;
- kosto të larta për bizneset dhe vonesa në qarkullimin e mallrave.

Këto sfida përbëjnë një pengesë serioze për konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare dhe për procesin e integritimit në BE.

1.4 Përfitimet strategjike

Zbatimi i kësaj strategjie do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta dhe afatgjata:

- Lehtësim tregtar: reduktim i kohës së zhdoganimit dhe rritje e efikasitetit në procedurat doganore;
- Integrim ekonomik: harmonizim me standardet e BE-së, duke i mundësuar Shqipërisë qasje në tregun e përbashkët;
- Transparencë dhe integritet: ulje të kontakteve fizike mes biznesit dhe administratës, me qëllim shmangien e korrupsionit;
- Siguri kombëtare: sisteme të avancuara të menaxhimit të riskut që parandalojnë kontrabandën dhe krimin ndërkufitar;
- Përfitime për bizneset: ulje e kostove administrative, thjeshtim i procedurave dhe përmirësim i mjedisit të investimeve, duke i bërë bizneset shqiptare plotësisht konkurruese në tregun ndërkombëtar.

1.5 Korniza strategjike dhe ligjore

Strategjia është në përputhje të plotë me:

- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2030;
- Strategjinë e Zhvillimit të Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030;
- Strategjinë e Reformës në Administratën Publike;
- Strategjinë e Biznesit 2023–2027 dhe plani i saj i zbatimit 2024 kanë përcaktuar prioritetet kryesore të reformës, duke përfshirë digjitalizimin, inovacionin teknologjik dhe rritjen e kapaciteteve institucionale;
- Angazhimet e marra nga Shqipëria në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- Strategjinë për evolucionin e bashkimit doganor (COM (2008) 169 final);
- Planin strategjik shumëvjeçar të BE-së për doganat elektronike (MASP-C);



- Listën e Sistemeve të dërguara nga DG Taxud dhe të përcjella zyrtarisht nga Zyra e Kryenegociatorit, nëpërmjet dokumentit “*Roadmap on development of digital customs systems required for the implementation of the EU customs legislation (updated 20 Jun 2025)*”.

Kjo strategji është, gjithashtu, e lidhur me procesin *screening* për kapitullin 29 “Bashkimi doganor”, që konsiderohen ndër kapitujt më të rëndësishëm të negociatave.

1.6 Misioni dhe vizioni

Misioni i Strategjisë është të transformojë Shërbimin Doganor të Republikës së Shqipërisë në një administratë moderne, digjitale, transparente dhe plotësisht të integruar me BE-në.

Vizioni i tij është që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një sistem doganor që funksionon sipas të njëjtave standarde, procedurave dhe teknologji si vendet anëtare të BE-së, duke ofruar shërbime të shpejta, të sigurta dhe efikase për qytetarët dhe bizneset.

KAPITULLI II ANALIZA E SITUATËS

2.1 Gjendja aktuale e Sistemit Doganor Shqiptar

Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë është një institucion kyç i administratës publike financiare, duke mbikëqyrur lëvizjen e mallrave, si dhe duke garantuar të ardhurat buxhetore nga taksat doganore, si dhe duke siguruar mbrojtjen e interesave ekonomikë e kombëtarë. Prej disa vitesh, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt modernizimit të këtij sistemi, duke kaluar nga procedurat manuale tradicionale tek përdorimi i teknologjisë së informacionit.

Administrata Doganore e Shqipërisë aktualisht ka në përdorim sistemin *ASYCUDA World (Sistemi i automatizuar për të dhënat doganore)*. Ky sistem gjithëpërfshirës i kompjuterizuar i menaxhimit doganor përfshin shumicën e procedurave të tregtisë së jashtme të trajtuara nga Administrata Doganore Shqiptare.

ASYCUDA World lehtëson përpunimin e listës së mallrave, deklaratave doganore, procedurave të kontabilitetit dhe listës së mallrave të magazinimit, duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e operacioneve doganore. Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore (*ASYCUDA World*) është një

sistem i kompjuterizuar i menaxhimit doganor që mbulon shumicën e procedurave të tregtisë së jashtme të administratës doganore shqiptare. Sistemi trajton deklaratat e listës së mallrave dhe doganore, procedurat e kontabilitetit dhe procedurat e listës së mallrave të magazinimit dhe pezullimit. Zbatimi i parë i *ASYCUDA ++* ishte në 2002 i cili në 2009 migroi në *ASYCUDA World (AW)*. Në vitet 2018 – 2019, u zbatua menaxhimi uniform i përdoruesit dhe nënshkrimi elektronik, duke vijuar pa letra. Në janar 2022 u finalizua procesi i përmirësimit të versionit më të fundit të sistemit AW dhe në vitin 2022 u zbatuan shërbimet e internetit për shërbimet doganore në sistemin *e-Albania*. AW ndërvepron me sistemin *C@TS, Self-Care, Bankat, Postën Shqiptare, SEED, ASYCUDA World of Kosovo*, etj. Ky sistem ka sjellë përmirësime në menaxhimin e deklaratave doganore dhe në gjurmueshmërinë e proceseve, por mbetet i fragmentuar dhe i kufizuar për sa i përket integritetit të tij me platformat doganore të Bashkimit Evropian.

2.2 Mangësitë kryesore të identifikuara

Analiza e situatës aktuale tregon se sistemi doganor shqiptar përballet me sfida strukturore dhe teknologjike për t'u adresuar, të cilat ndahen në disa fusha kryesore:

a) Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit

- Pajisje dhe serverë të vjetruar, me kapacitet të kufizuar për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Mungesë të kapaciteteve e sistemeve rezervë;
- Rrezikshmëri e lartë ndaj sulmeve kibernetike për shkak të nivelit të ulët të sigurisë digjitale.

b) Korniza ligjore dhe rregullatore

- Përafrim i Kodit Doganor të Shqipërisë me Kodin Doganor të BE-së (*Union Customs Code (UCC)*);
- Mungesë e akteve nënligjore dhe rregulloreve që garantojnë implementim të plotë të procedurave elektronike;
- Standardet për shkëmbimin e të dhënave dhe arkivimin elektronik nuk janë në përputhje të plotë me praktikën evropiane.

c) Burimet njerëzore

- Numër i kufizuar specialistësh të kualifikuar në fushën e IT-së dhe sistemeve doganore;
- Mungesë programesh të vazhdueshme trajnimi për sigurinë kibernetike, menaxhimin e riskut dhe ndërveprimin me sistemet e BE-së.



d) Bashkëpunimi ndërinstitucional

- Koordinimi jo plotësisht efektiv ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe institucioneve të tjera publike ligjzbatuese;

- Proceset shpesh mbivendosen dhe krijojnë vonesa, duke ulur efikasitetin e përgjithshëm të administratës.

2.3 Niveli i digjitalizimit të proceseve doganore

Sipas vlerësimeve të brendshme të Shërbimit Doganor, shumica e procedurave thelbësore janë ende pjesërisht të digjitalizuara. Prej datës 16.5.2019, deklarimi i mallrave në doganë realizohet *online* (pa letra), duke aplikuar nënshkrimin dhe vulosjen elektronike. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm që shoqëron deklaratën doganore është në formë elektronike dhe i bashkëngjitet deklaratës doganore. Me vendosjen e vulës elektronike të gjitha deklaratat doganore paraqiten në formë elektronike përveç deklaratave doganore që klasifikohen ose rikanalizohen në kanal të kuq (kontroll dokumentar dhe fizik të mallrave) paraqiten dhe në letra. Që prej marsit 2022, ADSH-ja ofron shërbime për bizneset nëpërmjet aplikacionit *e-Albania*, një portal qeveritar që integron sisteme të ndryshme institucionale.

Deri më sot janë digjitalizuar 38 shërbime doganore, ku përfshihen “Deklarata e thjeshtuar”, “Deklarata e statusit të tranzitit” dhe “Konfirmimi i pagesave të kryera nga subjektet në llogaritë doganore”. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofron aktualisht 43 shërbime *online*, dhe synon kalimin e të gjitha shërbimeve *online* deri në fund të vitit 2026.

Digjitalizimi i Shërbimeve Doganore: Është sistemi *backend*, ky sistem përpunon aplikacionet e paraqitura përmes platformës *e-albania*. Ai funksionon sipas flukseve të punës dhe afateve kohore të paracaktuara për çdo shërbim, duke siguruar që qytetarët të marrin përgjigje të menjëhershme të shoqëruara me dokumente të nënshkruara elektronikisht.

LIMS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik): Është sistemi i cili realizon regjistrimin dhe menaxhimin për analizat e mostrave të mallrave dhe është implementuar për herë të parë në vitin 2017. Sistemi është përmirësuar në vitin 2023 sipas strukturës së re të institucionit dhe fluksit të ri të punës përpunuese. Ky përmirësim e përfaqëson sistemin me strukturën e re të institucionit dhe fluksin e punës së përpunimit, duke

përmirësuar kështu saktësinë dhe shpejtësinë e analizës së mallrave.

ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave): I nisur si projekt nga Bashkimi Evropian në vitin 2019, ITMS-ja përfshin tetë module thelbësore të zhvilluara nga SIVECO. Sistemi u instalua në infrastrukturën *harduer* të AKSHI-t dhe iu dorëzua administratës doganore në shkurt 2024. Pas dorëzimit, administrata doganore kreu teste të plota bazuar në skenarë të propozuar nga SIVECO/IkubInfo, duke siguruar gatishmërinë operacionale të sistemit.

Aktualisht, janë disa sisteme të cilat janë në proces dhe nuk janë implementuar ende, si më poshtë:

- **NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit):** Ky projekt i mbështetur nga Banka Botërore ka nisur në mars 2020. Lidhur me paketën e prokurimit “Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Kontrolli i Cilësisë për Zbatimin e plotë të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit (NCTS) në Shqipëri” me nr. WBTF-ALB-121D, datë 3.6.2022, u zgjodh konsulenti fitues dhe u kontraktua nga Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU).

Në lidhje me procedurën e prokurimit “*Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit plotësisht në përputhje me EU-NCTS*”, ref. nr. WBTF-ALB-121B”, kompania fituese (NETCompany-Intrasoft) u zgjodh dhe u kontraktua nga CFCU-ja, në qershor 2024. ADSH-ja po punon me ekspertin ndërkombëtar për Strategjinë Kombëtare të TI-së, Udhërrëfyesin dhe Planin e Veprimit (NISRAP) për NCTS të cilën do t’ia përcjellë zyrtarisht TAXUD-it. Gjithashtu, ADSH-ja ka krijuar grupin e punës për zbatimin e “Sistemit të ri të Kompjuterizuar të Tranzitit NCTS”. Ky grup përbëhet nga ekspertë të ndryshëm të procedurave doganore, ligjeve, garancive, pagesave, IT, riskut, etj.

- **NSW (dritare e re e vetme):** Është një projekt i Bankës Botërore i cili ka filluar në tetor 2020. CFCU-ja kontraktoi kompaninë konsulente IOS Partners, që synon të përgatisë specifikimet teknike të nevojshme për fillimin e punës për zbatimin e Sistemit të Dritares së Vetme Kombëtare (NSW). Kompania *IOS Partners* ka përgatitur Raportin Fillestar dhe dokumentin TOR. TOR-ët janë miratuar nga BB-ja dhe tani nuk do të marrin asnjë kundërshtim nga dokumenti RFP i Bankës, që do të publikohet për tender nga CFCU-ja gjatë muajit



shtator. Procedura e prokurimit është në proces vlerësimi, në të cilin është krijuar një komision specifik për vlerësimin e tij.

2.4 Lidhja me sistemet e BE-së

Shqipëria është ende në fazat përgatitore për t'u lidhur me disa nga sistemet kryesore të BE-së.

Sistemi i BE-së	Gjendja në Shqipëri	Niveli i ndërveprimit	Shënime
NCTS (tranzit)	Në fazë përgatitore pilot	Pjesërisht	Pritet aderimi në Konventën e Tranzitit të Përbashkët
AES (eksport)	I pazbatuar	Mungon	Parashikuar për vitet 2026–2027
AIS (import)	I pazbatuar	Mungon	Parashikuar për vitet 2027–2028
EORI	I pazbatuar	Mungon	
TARIC	I pazbatuar	Mungon	Planifikohet për 2027

2.5 Sfidat e transformimit digjital

Procesi i transformimit digjital të doganave shqiptare do të duhet të adresojë:

- mungesën e ndërlidhjes me rrjetet evropiane;
- procedurat manuale dhe të ngadalta;
- infrastrukturën e vjetruar të IT-së;
- kapacitetin e ulët institucional për menaxhimin e projekteve digjitale.

Këto kufizime gjenerojnë kosto të larta administrative, një përvojë jo të favorshme për bizneset, si dhe një rrezik të lartë për mashtrimet dhe korrupsionin. Në të njëjtën kohë, ato e pengojnë Shqipërinë të bëhet pjesë e plotë e zinxhirit të integruar doganor evropian.

2.6 Justifikimi për reformën

Reforma e sistemit doganor digjital është një domosdoshmëri për:

- përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë ndaj BE-së;
- sigurimin e zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe të një mjedisi biznesi konkurrues;
- përmirësimin e menaxhimit të të ardhurave publike dhe uljen e evazionit fiskal;
- forcimin e luftës kundër kontrabandës dhe krimit ndërkufitar.

Moszbatimi i reformës rrezikon:

- ngadalësimin e negociatave të anëtarësimit në BE;
- kufizimin e aksesit në fondet evropiane;

- humbjen e mundësive për integrim në tregtinë ndërkombëtare të digjitalizuar.

2.7 Përfundimi i analizës

Nga analiza e mësipërme rezulton se administrata doganore shqiptare gjendet përballë një sfide dhe transformimi të plotë teknologjik dhe institucional për t'u përafuar me standardet evropiane. Ky transformim kërkon jo vetëm investime në infrastrukturë dhe teknologji, por edhe forcim të kuadrit ligjor, ndërtim të kapaciteteve njerëzore dhe rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional e rajonal.

KAPITULLI III

OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

3.1 Qëllimi i përgjithshëm

Me qëllim që sistemi doganor i Republikës së Shqipërisë të përafrohet me standardet e Bashkimit Evropian dhe t'i përshtatet nevojave gjithnjë e më të mëdha për digjitalizim, efikasitet dhe siguri të proceseve doganore, Strategjia përcakton një sërë objektivash themelore. Këto objektivat rrjedhin nga angazhimet e marra nëpërmjet Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2025–2030, nga Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030, si dhe nga kërkesat e përcaktuara në Strategjinë për Evolucionin e Bashkimit Doganor (COM (2008) 169 final).

Qëllimi kryesor i zhvillimit të Strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor të Shqipërisë me ato të Bashkimit Evropian është modernizimi dhe harmonizimi i këtyre sistemeve deri në vitin 2030, duke siguruar ndërveprimin, sigurinë dhe efikasitetin e proceseve doganore. Ky objektiv i përgjithshëm synon transformimin e administratës doganore shqiptare në një strukturë moderne dhe plotësisht të integruar me sistemet doganore të BE-së, duke mundësuar shkëmbim efikas të të dhënave, rritjen e transparencës, lehtësimin e tregtisë së ligjshme dhe garantimin e mbledhjes efektive të të ardhurave.

3.2 Objektivat specifikë dhe shtyllat strategjike

Objektivat e Strategjisë ndërtohen mbi pesë shtylla strategjike që mbulojnë të gjitha dimensionet thelbësore të modernizimit të administratës doganore shqiptare: infrastrukturën e teknologjisë së informacionit (TIK), proceset operative doganore, shërbimet dhe mbështetjen për biznesin, kuadrin



rregullator dhe strategjitë e TIK-ut, si dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Këto shtylla synojnë zbatimin e plotë të një sistemi doganor plotësisht digjital, të sigurt dhe të ndërveprueshëm, i cili lehtëson tregtinë e ligjshme, siguron mbledhjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe mbështet integrimin e Republikës së Shqipërisë në zonën doganore evropiane.

3.2.1 Shtylla 1: Zhvillimi i një sistemi doganor digjital, të integruar dhe koherent

Ky objektivi strategjik synon të realizojë një reformë strukturore dhe funksionale të administratës doganore, duke integruar teknologjitë moderne digjitale në të gjitha proceset kyçe doganore. Në kuadër të kësaj shtylle, do të zhvillohet një sistem i plotë elektronik doganor (CDPS – *Sistemi i Përpunimit të Vendimeve Doganore*), i cili do të jetë plotësisht i ndërveprueshëm me rrjetet dhe platformat e TIK-ut të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtij sistemi, Shërbimi Doganor synon të rrisë transparencën, të përmirësojë efikasitetin operativ, të forcojë sigurinë kibernetike dhe të sigurojë përputhshmëri të plotë me legjislacionin doganor evropian.

Zbatimi i këtij objektivi do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të unifikuar digjital doganor, i cili mundëson lidhjen në kohë reale me sistemet doganore evropiane (si p.sh.: NCTS, AES, AIS, EORI, REX, AEO), automatizon shkëmbimin e të dhënave midis autoriteteve dhe operatorëve ekonomikë dhe lejon menaxhimin e integruar elektronik të proceseve të deklarimit dhe kontrollit të autoritetit doganor. Përveç kësaj, sistemi i ri do të përfshijë elemente bashkëkohore të identifikimit dhe autentifikimit elektronik, si dhe nënshkrimin digjital, duke forcuar besimin dhe sigurinë në marrëdhëniet digjitale mes administratës shtetërore dhe komunitetit të biznesit.

Duke arritur këtë objektivi, administrata doganore do të shkurtojë ndjeshëm kohën e përpunimit të deklaratave doganore, do të minimizojë risqet e gabimeve njerëzore dhe do të krijojë një klimë lehtësuese për integrimin ekonomik me BE-në, duke lehtësuar tregtinë ndërkufitare, si dhe duke nxitur konkurrueshmërinë ekonomike të vendit.

Për të arritur këtë objektivi të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.1.1 Zhvillimi i një CDPS-je (*Sistemi i Përpunimit të Vendimeve Doganore*) të re shqiptare në përputhje me kërkesat e BE-së, që të mundësojë një

mjedis doganor plotësisht elektronik dhe të integruar në nivel evropian.

3.2.1.2 Modernizimi i sistemeve të kontrollit doganor dhe menaxhimit të riskut, duke integruar mjetet e avancuara të analizës së të dhënave, si dhe inteligjencës artificiale për të identifikuar dhe parandaluar riskun në kohë reale.

3.2.1.3 Optimizimi dhe digjitalizimi i procedurave të veçanta (regjimet doganore të posaçme si përpunimi aktiv/pasiv, magazinimi doganor, njoftimi i mbërritjes dhe pranimit të magazinimit të përkohshëm, etj.), në linjë me standardet evropiane INF-STP dhe INF-SP, për t'i bërë ato më efikase dhe transparente.

3.2.1.4 Zhvillimi dhe përsosja e sistemit të akcizës, duke e integruar atë me sistemet doganore dhe tatimore për një administrim më të mirë të taksave indirekte dhe përputhshmëri me *acquis* të BE-së në fushën e akcizave.

3.2.2 Shtylla 2: Modernizimi i administratës doganore dhe digjitalizimi i proceseve të brendshme

Transformimi digjital i shërbimit doganor nuk mund të arrihet pa një reformë të thellë të proceseve të brendshme. Prandaj, objektivi i dytë fokusohet te digjitalizimi i proceseve të mbështetjes së brendshme, si: menaxhimi i burimeve njerëzore, prokurimi, buxheti, logjistika përmes implementimit të një sistemi bashkëkohor ERP (planifikim të burimeve të brendshme) të përshtatur për nevojat e administratës doganore. Kjo do të mundësojë automatizimin dhe integrimin e funksioneve administrative, duke rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe koordinimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm të administratës.

Gjithashtu, të gjitha regjimet doganore (regjimet doganore të posaçme, si: përpunimi aktiv/pasiv, magazinimi doganor, njoftimi i mbërritjes, pranimit të magazinimit të përkohshëm dhe transiti, etj.) do të duhet të digjitalizohen plotësisht, në përputhje me standardet dhe formatet elektronike të kërkuara nga BE-ja (p.sh. përdorimi i sistemeve INF-STP/INF-SP për shkëmbimin e informacionit për procedurat e posaçme). Në të njëjtën kohë, sistemet për menaxhimin e riskut, parandalimin e mashtrimit dhe ndarjen automatike të kuotave tarifore do të forcohen duke zbatuar platforma dhe aplikacione të specializuara (si: AFIS, COPIS dhe TQS), të cilat rrisin kapacitetin e identifikimit të shkeljeve dhe garantimin e mbledhjes së saktë të detyrimeve



doganore. Paralelisht me këto, do të duhet të zhvillohet një sistem i integruar i menaxhimit të burimeve (fizike, teknologjike dhe njerëzore) për të optimizuar përdorimin e aseteve të administratës.

Këto veprime, marrë së bashku, do të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e efikasitetit operacional brenda administratës doganore dhe do të zvogëlojnë burokracinë e panevojshme. Proceset më të thjeshtuara dhe të automatizuara të brendshme do të reflektohen në shërbime më cilësore dhe më të shpejta për qytetarët dhe bizneset. Prandaj, për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.2.1 Optimizimi dhe digjitalizimi i plotë i procedurave doganore, duke krijuar module të posaçme elektronike për secilën procedurë (p.sh. tranziti elektronik, regjimet e përpunimit dhe magazinimit, etj.) në harmoni me sistemet evropiane.

3.2.2.2 Zbatimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të burimeve (fizike, TIK dhe njerëzore) për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës doganore, nëpërmjet investimeve strategjike, masave të avancuara për mbrojtjen e të dhënave, dhe mbështetjes digjitale të të gjitha proceseve operacionale. Ky sistem do të garantojë që infrastruktura kritike (si pajisjet *hardware*, rrjetet, bazat e të dhënave dhe vetë strukturat organizative) të jetë e aftë t'u përgjigjet kërkesave në rritje dhe sfidave emergjente.

3.2.3 Shtylla 3: Mbështetja e digjitalizimit të proceseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)

Në një kontekst ekonomik, ku konkurrueshmëria dhe shpejtësia janë kyçe, është thelbësore që marrëdhënia midis doganës dhe operatorëve ekonomikë të transformohet në mënyrë digjitale dhe të ofrojë shërbime të shpejta e transparente. Ky objektiv synon të zhvillojë zgjidhje moderne TIK që ofrojnë shërbime elektronike efikase dhe të gjithanshme për mjedisin e biznesit, duke krijuar platforma elektronike miqësore për përdoruesit, të disponueshme 24/7 dhe të integruara me sistemet përkatëse të BE-së.

Brenda kësaj shtylle, do të zhvillohet një sistem mbështetjeje teknike shumë-nivelësh (*help desk*), që t'u përgjigjet në mënyrë proaktive dhe të shpejtë kërkesave apo problemeve teknike të përdoruesve (si bizneseve edhe administratës doganore). Gjithashtu, do të integrohen funksionalitete digjitale

në procesin e komunikimit midis doganës dhe palëve të jashtme: aplikimet për autorizime doganore, llogaritja dhe pagesa elektronike e detyrimeve dhe menaxhimi elektronik i vendimeve doganore do të ofrohen tërësisht *online* dhe në kohë reale. Këto masa do të sigurojnë transparencë dhe parashikueshmëri më të madhe në zbatimin e regjimeve doganore, si dhe do të ulin ndjeshëm kostot e përputhshmërisë për operatorët ekonomikë (duke pakësuar dokumentacionin në letër, kohën e pritjes dhe ndërveprimet fizike).

Për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.3.1 Përmirësimi i shërbimeve elektronike doganore për komunitetin e biznesit, duke zgjeruar gamën dhe cilësinë e platformave digjitale (portalet e biznesit dhe aplikacionet mobile, etj.) ku operatorët ekonomikë mund të kryejnë të gjitha formalitetet doganore pa pengesa.

3.2.3.2 Shfrytëzimi strategjik i burimeve për mirëmbajtjen dhe modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknologjike dhe asaj fizike, në mënyrë që sistemet doganore të jenë vazhdimisht të disponueshme, të sigurta dhe të përditësuara me teknologjinë më të re.

3.2.3.3 Ngritjen e një kapaciteti rezervë për rikuperimin e shpejtë të sistemeve dhe të dhënave në rast fatkeqësish ose emergjencash. Kjo do të sigurojë që të dhënat konfidenciale doganore dhe biznesit të jenë të mbrojtura sipas standardeve më të larta dhe që operacionet doganore të mos ndërpriten edhe në rast të incidenteve madhore kibernetike apo fizike.

3.2.4 Shtylla 4: Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK-ut në dogana

Digjitalizimi i shërbimit doganor kërkon jo vetëm sisteme TIK me performancë të lartë, por edhe një kuadër rregullator, strategjik dhe organizativ të mirëpërcaktuar. Në këtë drejtim, objektivi i katërt synon të forcojë bazat strategjike dhe ligjore mbi të cilat mbështetet transformimi digjital i doganave.

Së pari, do të hartohet dhe zhvillohet një arkitekturë e integruar për TIK-un në sistemin doganor shqiptar, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes për të gjitha projektet dhe investimet e ardhshme në fushën e teknologjisë. Kjo arkitekturë do të sigurojë që sistemet e reja të jenë të përputhura me standardet evropiane dhe të mundësojnë



ndërveprim të plotë me sistemet e BE-së dhe agjencitë e tjera brenda vendit.

Gjithashtu, rregulloret e brendshme, politikat e sigurisë, protokollet e aksesit në të dhëna dhe rregullat e qeverisjes së IT-së do të rishikohen dhe përditësohen, me qëllim krijimin e një kuadri modern ligjor që mbështet një mjedis plotësisht të digjitalizuar. Kjo përfshin përshtatjen e legjislacionit doganor shqiptar me Kodin Doganor të BE-së, sa i përket përdorimit të dokumenteve elektronike dhe nënshkrimit digjital, miratimin e procedurave “pa letër”, si dhe garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe tregtare, në përputhje me rregulloren GDPR (rregullore e përgjithshme e mbrojtjes së të dhënave) të BE-së.

Për të përmirësuar monitorimin e investimeve dhe projekteve TIK, do të krijohet një regjistër i centralizuar i projekteve dhe dokumentacionit përkatës. Kjo do t'i mundësojë administratës doganore të ndjekë në mënyrë të rregullt progresin e secilit projekt, të sigurojë përputhshmërinë me standardet dhe afatet, si dhe të vlerësojë efikasitetin e shpenzimeve publike në TIK.

Për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohet objektivi specifik i mëposhtëm:

- 4.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një kornize të plotë të arkitekturës për TIK-un në dogana, që përcakton standardet teknike, proceset e menaxhimit të ndryshimit dhe kontrollit të cilësisë, dhe udhëzon integrimin e çdo sistemi të ri me infrastrukturën ekzistuese dhe sistemet e BE-së. Ky objektiv i veçantë siguron që transformimi digjital të mbështetet nga një strategji e qëndrueshme dhe një strukturë qeverisjeje që garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave.

3.2.5 Shtylla 5: Përmirësimi i aftësiave teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar

Suksesi i transformimit digjital varet drejtpërdrejt nga kapitali njerëzor. Për këtë arsye, objektivi i pestë i strategjisë fokusohet në forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të punonjësve, veçanërisht atyre në fushën e TIK-ut, si dhe në krijimin e kushteve që këta specialistë të qëndrojnë dhe të zhvillojnë karrierën e tyre brenda administratës doganore.

Do të duhen të organizohen kurse dhe trajnime të specializuara për stafin e TIK-ut dhe stafin tjetër doganor që punon me sistemet e reja digjitale. Këto trajnime do të duhet të mbulojnë fusha kyçe si ndërveprimi i sistemeve doganore me ato evropiane,

siguria kibernetike, administrimi i bazave të të dhënave, zhvillimi i *softver*-it, menaxhimi i projekteve TIK dhe analiza e të dhënave. Trajnimet do të ofrohen në mënyrë të vazhdueshme për të ndjekur ritmin e avancimit teknologjik dhe për të siguruar që stafi të jetë gjithmonë i përditësuar me praktikatat më të mira.

Në të njëjtën kohë, do të duhen të krijohen paketa motivuese dhe politika konkurruese të shpërblimit për personelin teknik. Kjo do të përfshijë skema stimuluesh (bonuse performance për arritjen e objektivave kyç), mundësi karriere dhe avancimi profesional brenda institucionit, si dhe një ristrukturim të skemës së pagave për profilet TIK, në mënyrë që ato të jenë konkurruese me tregun privat dhe të afta të tërheqin e të mbajnë specialistë të talentuar.

Kështu, për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohet objektivi specifik i mëposhtëm:

- 5.1 Sigurimi që punonjësit e administratës doganore të zotërojnë aftësitë e nevojshme në fushën e TIK-ut, përmes trajnimeve sistematike dhe certifikimeve profesionale, dhe njëkohësisht rritja e shkallës së mbajtjes së stafit të kualifikuar në TIK, falë krijimit të një mjedisi pune motivues, me kushte dhe paga konkurruese.

Përfitimet e synuara nga realizimi i objektivave të strategjisë

Zbatimi me sukses i strategjisë pritet të gjenerojë një sërë përfitimesh të rëndësishme për ekonominë, administratën dhe shoqërinë shqiptare, si në afat të shkurtër ashtu edhe në afat të gjatë:

- **Lehtësimi i tregtisë dhe integrimi ekonomik.** Procedurat doganore të digjitalizuara dhe të harmonizuara me ato të BE-së do të reduktojnë ndjeshëm kohën dhe koston e zhdoganimit për bizneset. Automatizimi i deklarimit dhe kontrollit do të thjeshtojë proceset për importuesit dhe eksportuesit, duke rritur volumin e tregtisë së ligjshme. Kjo klimë e përmirësuar biznesi do ta bëjë Shqipërinë më tërheqëse për investitorët e huaj dhe do të lehtësojë integrimin e saj në zinxhirët rajonal dhe evropian të furnizimit;

- **Rritja e efikasitetit administrativ dhe e të ardhurave buxhetore.** Sistemet e reja do të mundësojnë një shfrytëzim më të mirë të burimeve brenda doganës. Një sistem i avancuar i menaxhimit të riskut do të targetojë kontrollet doganore aty ku nevojiten realisht, duke shmangur kontrollet e



tepërta dhe vonesat e panevojshme. Kjo rrit efikasitetin e stafit dhe ul kostot operative. Njëkohësisht, mbledhja e detyrimeve doganore dhe akcizave do të bëhet më e saktë dhe më e plotë falë eliminimit të gabimeve dhe shmangieve, si rezultat, të ardhurat doganore në buxhetin e shtetit pritet të rriten;

- **Transparenca, llogaridhënia dhe ulja e korrupsionit.** Kalimi drejt shërbimeve elektronike zvogëlon ndërveprimet e drejtpërdrejta fizike midis zyrtarëve doganorë dhe qytetarëve/bizneseve, duke kufizuar hapësirat për sjellje korruptive. Çdo transaksion doganor do të lërë gjurmë elektronike, e cila e bën më të lehtë identifikimin dhe ndëshkimin e parregullsive. Për qytetarët dhe bizneset, transparenca rritet sepse ata do të kenë mundësi të ndjekin statusin e deklaratave apo kërkesave të tyre *online* në kohë reale, duke e ditur saktësisht se në cilin hap ndodhen dhe cili zyrtar po e trajton çështjen. Kjo forcon besimin e publikut tek administrata doganore dhe rrit llogaridhënien e kësaj të fundit;

- **Forcimi i sigurisë kombëtare dhe mbrojtja e qytetarëve.** Me implementimin e sistemeve moderne, doganat do të kenë mjete shumë më efikase për të zbuluar kontrabandën dhe trafikun e paligjshëm. Algoritmet e riskut dhe analizat inteligjente do të ndihmojnë në kapjen më të shpejtë të mallrave të rrezikshme (si: droga, armë, mallra kontrafakte apo me bio-rreziqe). Kjo do të përmirësojë sigurinë e kufijve dhe do të mbrojë qytetarët nga mallra të pasigurta apo të paligjshme. Një administratë doganore më e fortë dhe e digjitalizuar kontribuon, gjithashtu, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, duke kontrolluar më mirë lëvizjen e mallrave që mund të financojnë apo fshehin veprimtari kriminale;

- **Përmirësimi i integritetit dhe reputacioni ndërkombëtar.** Përfitim i prekshëm, ndonëse indirekt, është rritja e reputacionit të Shqipërisë si një vend që arrin të zbatojë reforma moderne dhe komplekse. Përmirësimi i integritetit dhe reputacionit do të demonstrojë përkushtimin e vendit ndaj përmirësimit të standardeve të BE-së. Kjo do të reflektohet pozitivisht në ecurinë e negociatave të anëtarësimit, duke e afruar Shqipërinë me momentin e anëtarësimit të plotë. Një administratë doganore e standardeve evropiane do të thotë se Shqipëria, në momentin e anëtarësimit, mund të operojë pa probleme brenda Unionit

Doganor të BE-së, pa pasur nevojë për periudha të gjata tranzitore;

- **Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve dhe bizneseve.** Përfituesit kryesorë janë qytetarët dhe komuniteti i biznesit. Modernizimi i doganave do të thotë shërbime më të shpejta, më të besueshme dhe me cilësi më të lartë. Bizneset do të shpenzojnë më pak kohë në kufi dhe në plotësimin e dokumentacionit, duke sjellë ulje të kostove dhe rritje të produktivitetit. Qytetarët (udhëtarët, konsumatorët) do të përfitojnë nga procedura kufitare më të shpejta dhe siguri më e madhe për mallrat që hyjnë në vend. Këto përmirësime në shërbim rrisin klimën pozitive ekonomike dhe sociale, duke krijuar një mjedis ku respektohet ligji, lehtësohet biznesi dhe mbrohen interesat publike.

Në përfundim, objektivat dhe shtyllat strategjike të paraqitura në këtë kapitull përbëjnë një plan të mirëmenduar për transformimin e plotë të sistemit doganor shqiptar gjatë periudhës 2025–2030. Përmes zbatimit të këtyre objektivave që nga krijimi i sistemeve të reja digjitale dhe integrimi me rrjetet evropiane, deri tek fuqizimi i kuadrit ligjor dhe aftësive njerëzore, shërbimi doganor i Shqipërisë do të shndërrohet gradualisht në një administratë moderne, transparente dhe me performancë të lartë, e cila i shërben me efektivitet ekonomisë kombëtare dhe garanton sigurinë në kufij.

Realizimi i plotë i strategjisë do të sigurojë që, në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria të ketë një infrastrukturë doganore dhe kuadër operativ që funksionon në unison me atë të vendeve anëtare. Kjo do të thotë se vendi do të jetë gati të përfshihet në Unionin Doganor të BE-së pa pengesa, duke zbatuar në praktikë katër liritë e tregut të brendshëm dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre. Një administratë doganore e reformuar do të kontribuojë, gjithashtu, në rritjen ekonomike të vendit, përmirësimin e klimës së biznesit dhe mbrojtjen e interesave fiskalë e të sigurisë së Shqipërisë.

Në terma afatgjatë, investimi në modernizimin doganor është investim në të ardhmen evropiane të vendit. Kjo strategji krijon premisat për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim të suksesshëm, duke dërguar një mesazh të qartë se Shqipëria është e gatshme të marrë përgjegjësitë e anëtarësimit dhe të kontribuojë në mënyrë të barabartë në familjen evropiane.



KAPITULLI IV SISTEMET QË DO TË ZBATOHEN

Në kuadër të harmonizimit me Kodin Doganor të Bashkimit Evropian (UCC) dhe Planin Strategjik Shumëvjeçar të BE-së për Doganat elektronike (MASP-C), Shqipëria do të zbatojë një sërë sistemesh të informacionit doganor gjatë periudhës 2025–2030. Këto sisteme do të garantojnë ndërveprimin teknik me platformat e BE-së, rritjen e eficientës së procedurave doganore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkufitare.

Më poshtë përshkruhen sistemet kryesore që do të implementohen, së bashku me qëllimin, karakteristikat kryesore, ndikimin në biznes, shkallën e integritimit me BE-në dhe përparësitë kryesore të secilit.

4.1 Sistemi i Shkëmbimit të Certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së (EU CSW - CERTEX)

Programi “*New Single Window*” për doganat është një iniciativë moderne që synon të lehtësojë dhe përshpejtojë procedurat doganore përmes një platforme të integruar digjitale. Ky sistem u ofron bizneseve dhe institucioneve mundësinë që të dorëzojnë dokumentacionin dhe të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave përmes një pike të vetme kontakti. Nëpërmjet këtij programi rritet transparenca, zvogëlohet koha e përpunimit dhe kostot administrative, duke kontribuar në përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe në forcimin e kontrollit kufitar.

Nëpërmjet këtij sistemi synohet:

- Të thjeshtohet aksesin: I lejon përdoruesit të aksesojë shërbime të shumta përmes një identiteti të vetëm digjital, duke eliminuar nevojën për të krijuar llogari të veçanta për shërbime të ndryshme qeveritare;

- Të rrisë sigurinë: Duke përdorur mekanizma të fuqishëm vërtetimi, sporteli i vetëm ndihmon në mbrojtjen e informacionit personal dhe të ndjeshëm të përdoruesve nga aksesin i paautorizuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e shërbimeve qeveritare ku siguria dhe privatësia e të dhënave janë parësore;

- Të përmirësojë efikasitetin: Sporteli i vetëm lehtëson ndërveprimet më të shpejta dhe më efikase me shërbimet qeveritare, duke reduktuar dokumentet dhe vizitat fizike në zyrat qeveritare.

Kjo qasje ndihmon për të kursyer kohë, kosto dhe burime si për përdoruesit ashtu edhe për agjencitë qeveritare;

- Të promovojë përfshirjen digjitale: Duke ofruar një identitet të unifikuar digjital, sporteli i vetëm mbështet synimet e qeverisë për të rritur përfshirjen digjitale dhe për të siguruar që më shumë qytetarë të mund të përfitojnë nga komoditeti i shërbimeve *online*;

- Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien: Sporteli i vetëm ndihmon në rritjen e transparencës në ndërveprimet midis qytetarëve dhe qeverisë. Ai, gjithashtu, ndihmon në llogaridhënien, duke ndjekur kërkesat e shërbimit dhe përmbushjen e tyre.

Nëpërmjet këtij sistemi synohet, gjithashtu, që të ekzistojë një portë e vetme digjitale ku operatorët ekonomikë dorëzojnë vetëm një herë të dhënat për import/eksport/transit dhe ato shpërndahen automatikisht tek të gjitha autoritetet.

Ky sistem synohet që të implementohet nëpërmjet projektit “*Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project – Albania*” me Bankën Botërore.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka ngritur me urdhrin nr. 16349/1, datë 21.9.2022, “Për ngritjen e grupit ndërsektorial të punës për krijimin e dritares së vetme kombëtare për doganat, në kuadër të projektit ‘Lehtësimi i tregtisë dhe transporti në Ballkanin Perëndimor me një qasje programimi me disa faza’”, projekt i nisur që në tetor 2020.

Një ekspert ligjor i dedikuar është punësuar për të mbështetur NSW për identifikimin dhe mbështetjen e projektit në zgjidhjen e çështjeve ligjore. Analiza e legjislacionit të përgjithshëm ekzistues identifikoi se kuadri ligjor aktual është përmirësuar, përafuar dhe modernizuar vazhdimisht në përputhje me *acquis* të BE-së dhe është i vendosur mirë për të kontribuar në bazën ligjore për krijimin e një NSW.

4.2 Sistemi i Importit të Mallrave Kulturore (sistemi ICG)

Sistemi i Importit të Mallrave Kulturore (ICG) është një platformë elektronike e centralizuar e krijuar nga Bashkimi Evropian për të mbështetur zbatimin e rregullores (BE) 2019/880 mbi hyrjen dhe importimin e mallrave kulturore. Ky sistem ka për qëllim të parandalojë tregtinë e paligjshme të mallrave kulturore dhe të mbrojë trashëgiminë kulturore të vendeve të treta, duke siguruar që



mallrat të kenë kaluar në mënyrë të ligjshme përmes doganave të vendeve të origjinës.

Sistemi ICG siguron që mallrat kulturore të mos importohen në BE nëse janë eksportuar në mënyrë të paligjshme nga vendi i origjinës. Kjo masë është e rëndësishme për të mbrojtur pasuritë kulturore nga vjedhjet dhe shkatërrimi, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore globale.

ICG-ja lejon shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve doganore dhe institucioneve kompetente për trashëgiminë kulturore. Ky shkëmbim informacioni është thelbësor për të siguruar që mallrat kulturore të importuara në BE janë të ligjshme dhe për të parandaluar hyrjen e mallrave të paligjshme.

Sistemi ICG mbështet zbatimin e Konventës së UNESCO-s për ndalimin e importit dhe eksportit të paligjshëm të mallrave kulturore. Ky bashkëpunim ndërkombëtar është i rëndësishëm për të krijuar një rrjet të fortë mbrojtjeje për pasuritë kulturore dhe për të luftuar tregtinë e paligjshme të mallrave kulturore në nivel global.

Sistemi ICG është pjesë e platformës elektronike TRACES, e cila përdoret për të menaxhuar aplikimet për licencat e importit dhe deklaratat e importuesve. Përdoruesit duhet të regjistrohen në portalin TRACES për të paraqitur aplikimet e tyre. Ky sistem është i integruar me mjedisin e Dritares së Vetme të Doganave të BE-së (EU CSW-CERTEX), duke mundësuar shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve doganore dhe institucioneve kompetente për trashëgiminë kulturore.

Autoritetet kompetente kombëtare, si ministria përgjegjëse për kulturën, IKRTK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, do të sigurojnë aksesin (“login”) përmes një shfletuesi të thjeshtë në internet të siguruar nga BE-ja, për të mundësuar përdorimin e sistemit nga stafi i tyre.

Subjektet që kërkojnë të importojnë mallra kulturore, duhet të regjistrohen dhe të logohen në sistemin ICG për të plotësuar aplikimet e nevojshme për import, duke siguruar që të gjitha të dhënat dhe dokumentet të jenë të verifikueshme dhe në përputhje me rregulloren (EU) 880/2019, me të cilën RSh-ja pritet të përafrohet deri në T4 2026 nëpërmjet amendimit të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

4.3 Sistemi i Kontrollit të Importit të UCC 2 (ICS2)

ICS2 është brezi i dytë i Sistemit të Kontrollit të Importit për menaxhimin e deklaratave të paraardhjes (*Entry Summary Declarations – ENS*) dhe informacionit të sigurisë për mallrat që hyjnë në territorin doganor të unionit. Projekti ICS2 sjell një përmirësim të ndjeshëm në sigurinë e zinxhirit furnizues, duke adresuar mangësitë e sistemit të mëparshëm. ICS2 operon në disa faza implementimi në nivel BE-je. Aktualisht mbulon trafikun ajror (*Release 2*), ndërsa pritet shtrirja në transportin detar, hekurudhor dhe rrugor (*Release 3*), deri në vitin 2024–2025. Për Shqipërinë, ICS2 do të zbatohet për të gjitha mënyrat e transportit gjatë fazës së fundit të projektit, me qëllim që të jetë plotësisht funksional para anëtarësimit (të paktën deri në 2028). Sistemi automatizon formalitetet e sigurisë në hyrje, të dhënat e ENS dorëzohen elektronikisht nga transportuesit ose deklaruuesit para mbërritjes së mallit dhe u nënshtrohen analizave të riskut nga dogana. ICS2 përmirëson cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave, si dhe ndarjen e tyre midis administratave, duke garantuar që doganat të disponojnë informacione të mjaftueshme përpara se malli të arrijë në kufi.

Zbatimi i ICS2 do të ndikojë kryesisht te transportuesit ndërkombëtarë, agjentët doganorë dhe korrierët postarë/ekspres. Këto subjekte do të duhet të përshtatin sistemet e tyre IT për të gjeneruar dhe transmetuar mesazhet e reja të ENS brenda afateve të përcaktuara (p.sh. për dërgesat ajrore, para ngritjes së avionit nga vendi i nisjes). Edhe pse kjo kërkesë shtesë mund të duket si barrë fillestare, në afatgjatësi ICS2 rrit sigurinë dhe besueshmërinë e logistikës. Mallrat do të kalojnë kufirin me më pak vonesa nëse të dhënat e ENS-së janë dorëzuar në kohë dhe janë vlerësuar pa risk. Për importuesit, ICS2 do të thotë që ata do të njoftohen më herët për mbërritjen e mallrave, pasi njoftimi i mbërritjes (AN) dhe njoftimi i paraqitjes (PN) do të jenë pjesë e procesit të automatizuar. Për bizneset *e-commerce* dhe postare, ICS2 sjell procedura më të qarta për dërgesat e vogla, duke u mundësuar atyre të sigurojnë informacionin e nevojshëm paraprakisht dhe kështu të shmangin kthimet apo bllokimet e pakove në doganë.

Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e territorit doganor të BE-së, adoptimi i ICS2 para aderimit do të sigurojë një tranzicion pa probleme



në momentin e anëtarësimit. Gjatë fazës para anëtarësimit, administrata doganore mund të lidhet me komponentët qendrorë të ICS2, në kuadër të marrëveshjeve të asistencës ose pilotprojekteve rajonale, veçanërisht për shkëmbimin e informacionit të sigurisë me doganat e vendeve fqinje anëtare. Integrimi nënkupton ngritjen e një Ndërfaqeje Kombëtare për Tregtarët (*National Trader Portal*), e cila do të shërbejë si pika e dorëzimit të ENS-ve nga operatorët ekonomikë. Kjo ndërfaqe do të lidhet me sistemin qendror të ICS2, duke i atribuuar Shqipërisë rolin e “Shtetit anëtar” në rrjet për qëllime të përpunimit të të dhënave. Për më tepër, Shqipëria do të zbatojë procedurat e përbashkëta: p.sh., oraret standarde të dorëzimit të ENS (24 orë para ngarkesës detare, 4 orë para trenit, 1 orë para kamionit, etj.), kriteret e analizës së riskut të përcaktuara nga BE-ja dhe shkëmbimin e mesazheve të kontrollit (qoftë rekomandime kontrolli, apo rezultate kontrolli) me vendet e tjera. Integrimi i plotë me ICS2 do të arrihet kur Shqipëria të bëhet anëtare, por përgatitjet teknike do të mbyllën brenda vitit 2028.

ICS2 forcon mbrojtjen e kufijve kundrejt kërcënimeve të sigurisë dhe terrorizmit, duke mundësuar identifikimin e mallrave të rrezikshme para se ato të mbërrijnë fizikisht. Kjo përmirëson sigurinë kombëtare dhe atë evropiane në tërësi. Nga ana ekonomike, implementimi i ICS2 do të vendosë Shqipërinë në një pozitë më të mirë për lehtësimin e tregtisë: me procedura të unifikuara sigurie, mallrat që kalojnë tranzit nëpër Shqipëri drejt BE-së (apo anasjelltas) do t'i nënshtrohen një administrimi unik risku, duke evituar kontrollat e dyfishta. Për administratën doganore, ICS2 ofron mjete analitike të avancuara përmes grumbullimit të të dhënave të përbashkëta, duke mundësuar analizimin e trendeve të riskut në dërgesat globale. Kjo rrit aftësinë e parashikimit dhe përgatitjes ndaj skemave të reja të paligjshme.

ICS2 është një tregues i përkushtimit ndaj standardeve më të larta të BE-së; zbatimimi i suksesshëm i tij do të demonstrojë kapacitetet teknike të Shqipërisë për të menaxhuar flukset hyrëse sipas praktikave më të mira evropiane, duke i dhënë një shtysë pozitive procesit integrues.

4.4 Sistemi i Menaxhimit të Riskut Doganor (CRMS2)

Sistemi i Menaxhimit të Riskut Doganor (CRMS) mundëson komunikimin, ruajtjen dhe shkëmbimin

e informacionit mbi riskun midis zyrtarëve operativë dhe qendrave të analizës së rrezikut në shtetet anëtare të BE-së. Është një element kyç në zhvillimin e Kuadrit të Menaxhimit të Riskut të Unionit, pasi lehtëson ndërhyrjen doganore në të gjithë BE-në për risqe më të larta si në kufirin e jashtëm të BE-së ashtu dhe brenda kufijve të saj. CRMS-ja lidh të gjitha qendrat kombëtare të Analizës së Riskut Doganor të Shteteve Anëtare të BE-së por kanë akses edhe disa vende të treta, si: Zvicra, Norvegjia dhe Irlanda e Veriut. Në rast krize këto qendra janë në pozicionin më të mirë për të përhapur informacionin e riskut tek njerëzit e duhur në kufirin e jashtëm dhe për të siguruar që kontrollat të kryhen në mënyrë adekuate.

CRMS2 është një sistem qendror që përdoret për shkëmbimin e të gjitha llojeve të informacionit të riskut në zinxhirin e furnizimit. Përdoret në kontekstin e zbatimit të kornizës së përbashkët të menaxhimit të riskut dhe është një mjet mbështetës nën CRMS, pasi ofron Zonat e Kontrollit Prioritar (PCA) dhe Menaxhimin e Krizave. Ky aplikacion mbështet bashkëpunimin midis zyrave doganore të shteteve anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian.

Qëllimi i CRMS2 është të ofrojë një platformë të integruar dhe të fuqishme për oficerët doganorë të BE-së nga të gjitha shtetet anëtare për të shkëmbyer lehtësisht informacionin, shpejt dhe në mënyrë të sigurt mbi risqet e mundshme, në mënyrë që ata të mund të marrin masat e nevojshme. Ky sistem mbulon një gamë të gjerë risqesh, siç janë risqet e sigurisë që lidhen me armët, shëndetin, mjedisin, sigurinë e produkteve, risqet financiare dhe tregtare, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe kontrollat e parave.

CRMS2 është i ndarë në disa fusha kryesore të njohura, si:

- Formulari i Informacionit të Riskut (RIF);
- Menaxhimi i Krizave (CM);
- Zona e Kontrollit Prioritar (PCA);
- Shërbimi i Bashkëpunimit për Menaxhimin e Riskut (RMCS);
- Platforma e Informacionit të Riskut dhe Kontrollit (PRCI);
- Faqe/adresa raportimi;
- Menaxhimi i Përdoruesve;
- Paneli i Administrimit (vetëm për Administratorët Kombëtarë).

Një nga fushat më të rëndësishme të këtij sistemi është Formulari i Informacionit të Riskut (RIF) që



plotësohet në internet dhe vihet menjëherë në dispozicion të të gjitha zyrave doganore të lidhura në CRMS2. Ky dokument kontribuon në ekuivalentimin e kontrollit doganor në kufirin e jashtëm të Unionit, në lidhje me risqet e reja të identifikuar.

Për zbatimin e CRMS2, Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Riskut në Shqipëri do të komunikojë me specifikimet e CRMS2 nëpërmjet ndërfaqes së përdoruesit/shërbimit të internetit. Kjo do të lejojë përdoruesit që të jenë në gjendje të krijojnë Formularët e Informacionit të Riskut (RIF) në CRMS2, duke përdorur shërbime të automatizuara, të gjejnë RIF-et ekzistuese të ruajtura në CRMS2 dhe të marrin informacion të detajuar rreth tyre, duke përfshirë bashkëlidhjet.

Deri në vitin 2030, Administrata doganore do të bëjë të mundur arritjen e komunikimit të Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Riskut me sistemin CRMS2, duke e bërë Administratën Doganore Shqiptare pjesë të Kornizës së Përbashkët të Menaxhimit të Riskut me vendet anëtare të BE-së. Kjo do të çojë në shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt me këto vende, përcaktimin e zonave prioritare të kontrollit, si dhe marrjen e masave për kryerjen e kontrolleve dhe parandalimin e risqeve. Në këtë mënyrë, vendi ynë do të kontribuojë në rritjen e nivelit të mbrojtjes dhe sigurisë për qytetarët e saj dhe të BE-së, mbrojtjen e interesave financiarë të tyre, si dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme.

4.5 Sistemi i Vendimeve Doganore të UCC (CDS)

Sistemi harmonizon proceset që lidhen me zbatimin, vendimmarrjen dhe menaxhimin e vendimeve doganore, duke standardizuar dhe menaxhuar elektronikisht të dhënat e aplikimit dhe vendimmarrjes/ autorizimit në të gjithë Unionin. Projekti mbulon vendimet kombëtare dhe shumëshetërore anëtare të përcaktuara nga UCC-ja dhe mbulon komponentët e sistemit të zhvilluar në mënyrë qendrore në nivel Unioni. Ky sistem evropian menaxhon procesin e autorizimit, si dhe lehtëson konsultimet gjatë periudhës së vendimmarrjes.

Shqipëria synon të zhvillojë sistemin i cili do të ndërveprojë me sistemin e BE-së dhe do të lejojë komunikimin midis Shërbimit Doganor, operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë, me qëllim paraqitjen dhe përpunimin e aplikimeve dhe

vendimeve, si dhe menaxhimin e vendimeve që lidhen me autorizimet, përkatësisht ndryshimet, revokimet, anulimet dhe pezullimet.

Sistemi do të përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

a) një portal për operatorët ekonomikë (*e-albania*) ku të realizohen aplikimet;

b) një sistem menaxhimi vendimesh doganore.

Sistemi do të përdoret për qëllimin e paraqitjes dhe përpunimit të kërkesave të mëposhtme për autorizime, si dhe për qëllimin e menaxhimit të vendimeve që lidhen me kërkesat ose autorizimet:

a) autorizim për të paraqitur një deklaratë doganore, duke futur të dhëna në të dhënat e deklaruesit, duke përfshirë edhe për regjimin e eksportit;

b) autorizim i centralizuar i zhdoganimit;

c) autorizim për përdorim të rregullt të një deklarate të thjeshtuar;

d) autorizim për statusin e peshuesit të autorizuar të bananeve;

e) autorizim për vetëvlerësim;

f) autorizim për funksionimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm;

g) autorizim për të operuar ambiente magazinimi për magazinimin doganor të mallrave;

h) autorizim për të përdorur regjimin e përpunimit të brendshëm;

i) autorizim për të përdorur regjimin e përpunimit të jashtëm;

j) autorizimin për të përdorur regjimin e përdorimit përfundimtar;

k) autorizim për të përdorur regjimin e lejimit të përkohshëm;

l) autorizim për statusin e marrësit të autorizuar për procedurën e tranzitit;

m) autorizim për statusin e marrësit të autorizuar për operacionet TIR;

n) autorizim për statusin e dërguesit të autorizuar për procedurën e tranzitit;

o) autorizim për statusin e emetuesit të autorizuar;

p) autorizim për të përdorur vula speciale;

q) autorizim për të përdorur një deklaratë tranziti me një grup të dhënash të reduktuara;

r) autorizim për të përdorur një dokument transporti elektronik si deklaratë doganore;

s) autorizim për të vendosur shërbime të rregullta të transportit detar;



t) autorizim për të ofruar një garanci gjithëpërfshirëse, duke përfshirë një ulje ose përjashtim të mundshëm;

u) autorizimin për të shtyrë pagesën e detyrimeve doganore, në masën që leja nuk jepet në lidhje me një operacion të vetëm;

v) autorizim për të thjeshtuar përcaktimin e shumave që janë pjesë e vlerës doganore të mallrave.

Implementimi i sistemit të vendimeve doganore do të ketë disa përparësi kryesore:

- Harmonizim ligjor dhe teknik me Kodin Doganor të Unionit;

- Transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të autorizimeve doganore;

- Lehtësim për bizneset, të cilat mund të kryejnë formalitetet doganore *online*;

- Siguri dhe besueshmëri më e lartë, falë përdorimit të nënshkrimit digjital dhe standardeve të BE-së;

- Përgatitje për anëtarësimin në BE, duke siguruar që Shqipëria të ketë një sistem të barasvlershëm me atë të shteteve anëtare para hyrjes në Union.

Duke u mbështetur në këtë zhvillim, Shqipëria synon që deri në vitin 2030 të ketë përfunduar të gjithë hapat teknikë dhe ligjorë për implementimin e CDS Albania, duke ngritur komponentin e vet kombëtar dhe duke e bërë atë plotësisht të ndërveprojë me sistemin qendror të BE-së.

4.6 Sistemi Uniform i Menaxhimit të Përdoruesit & Nënshkrimit Digjital (UUM&DS)

Menaxhimi Uniform i Përdoruesve dhe Nënshkrimi Digjital, i njohur shkurt si UUM&DS (*Uniform User Management & Digital Signature*), është një sistem i përbashkët i infrastrukturës së IT-së doganore të BE-së që siguron menaxhimin e unifikuar të identiteteve të përdoruesve, kontrollin e aksesit dhe shfrytëzimin e nënshkrimit elektronik në të gjithë sistemet doganore elektronike. Qëllimi kryesor i UUM&DS është të mundësojë një akses të harmonizuar dhe të drejtëpërdrejtë për operatorët ekonomikë në shërbimet doganore digjitale, pavarësisht nëse këto shërbime janë të niveleve kombëtare apo qendrore të BE-së. UUM&DS krijon një identitet të vetëm elektronik për një përdorues (p.sh. një kompani importuese apo agjent doganor) që vlen në mbarë sistemet e ndryshme nga aplikimet për vendime doganore qendrore deri tek deklaratimet doganore kombëtare, duke siguruar

autenticitetin e përdoruesit dhe vlefshmërinë ligjore të veprimeve të tij. Komponenti i nënshkrimit digjital brenda UUM&DS garanton që çdo deklaratë apo dokument elektronik i paraqitur nga përdoruesi është i firmosur në mënyrë të sigurt elektronikisht, duke i dhënë të njëjtën vlerë ligjore si një nënshkrim fizik. Ky sistem uniform është bërë pjesë integrale e portaleve kryesore doganore të BE-së dhe është projektuar të respektojë standardet më të larta të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në Shqipëri ekziston portali qeveritar *e-Albania*, ku të gjithë qytetarët dhe bizneset disponojnë llogari personale të certifikuara. Ky portal shërben si pikë unike hyrëse (*Single Sign-On*) dhe *login*-i i tij mund të integrohet në sisteme të tjera të administratës publike, përfshirë sistemet doganore. Në këtë mënyrë, qytetarët dhe bizneset, bazuar në konfigurimet e realizuara, mund të aksesojnë sisteme të ndryshme duke përdorur kredencialet e *e-Albania*-s, pa qenë e nevojshme të kenë llogari të dedikuara për secilin sistem.

Për punonjësit e administratës shtetërore, përfshirë ata të Doganave të Shqipërisë, përdoret sistemi i *Azure Entra ID* i administruar nga AKSHI, i cili mund të integrohet në sistemet doganore. Ky *login* i unifikuar u mundëson punonjësve që të identifikohen me kredencialet e *email*-it zyrtar të aksesojnë sistemet për të cilat u është dhënë autorizimi. Këto dy mënyra të menaxhimit të identitetit (*login* për qytetarë/biznese përmes *e-Albania*-s dhe *login* për administratën përmes *Entra ID*) do të përdoren në sistemet e Administratës Doganore, duke u aplikuar sipas nevojave dhe profileve të përdoruesve.

Aktualisht është duke u punuar për integrimin e tyre në sistemin NCTS, dhe do të vijojë me integrimin edhe në sisteme të tjera.

Gjithashtu, në Shqipëri ekziston infrastruktura PKI (*Public Key Infrastructure*), e cila shërben për nënshkrim elektronik të vlefshëm ligjorisht për qytetarët, bizneset dhe administratën publike. Ky shërbim është integruar në sistemin *backend* ku procesohen aplikimet e qytetarëve në *e-Albania*, në sistemin LIMS dhe po integrohet edhe në sistemin NCTS.

Sistemi UUM&DS do të përdoret për të siguruar vërtetimin dhe verifikimin e aksesit të operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë, në mënyrë që të kenë akses në sistemet doganore, duke përdorur EU



Login i cili është opsioni më i thjeshtë dhe i rekomanduar nga BE-ja, pasi përdor funksionalitetin e plotë të UUM&DS, të ofruar në mënyrë qendrore nga BE-ja.

4.7 Sistemi i Eksportuesve të Regjistruar të UCC (REX)

Sistemi REX është një sistem qendror elektronik i BE-së, i menaxhimit të eksportuesve të regjistruar në BE. Eksportuesit regjistrohen në një bazë të dhënash nga Autoritetet Doganore të vendit anëtar, për të pasur të drejtë të vetëdeklarojnë origjinën preferenciale për mallrat që eksportojnë në kuadër të regjimit tregtar preferencial të BE-së. Ky sistem është një platformë që lidh operatorët ekonomikë, doganat kombëtare dhe sistemin e BE-së, dhe është i disponueshëm si një ndërfaqe e bazuar në *web* mbi CCN. Për këtë nuk kërkohet zhvillim sistemi nga ana e Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, është e detyruar që deri në momentin e anëtarësimit të garantojë plotësimin e disa kërkesave të domosdoshme. Në këtë kuadër, duhet të sigurohet që operatorët ekonomikë eksportues të cilët do të regjistrohen në sistemin REX përmes rrjetit CCN të pajisen paraprakisht me numër EORI, të kryhet regjistrimi dhe identifikimi i tyre në sistemin REX, të përgatitet një skedar në formatin CSV që përmban informacionin për eksportuesit e identifikuar si kandidatë për regjistrim përpara anëtarësimit, të realizohet testimi i këtij skedari në një mjedis të posaçëm prove dhe në ditën e anëtarësimit, të njoftohen eksportuesit e regjistruar për aktivizimin e skedarit CSV.

4.8 Informacioni i Detyrueshëm Tarifor Evropian (EBTI)

Sistemi IT për të mbështetur procesin e lëshimit të vendimeve detyruese tarifore BTI, ka si qëllim të sigurojë lëshimin e saktë të të gjitha IDT-ve dhe të ketë një bazë të dhënash të të gjitha aplikimeve dhe IDT-ve të lëshuara. Kjo kërkon që mbajtësi të përdorë një referencë IDT kur deklaron mallrat e mbuluara prej saj.

Ky është një modul sikurse modulet e tjerë që përfshihen në TARIC për të cilët është zhvilluar sistemi ITMS, në kuadër të projektit sipas kontratës me BE-në dhe që pritet që të krijohet mundësia e testimit në ambientet e testimit të serverëve pranë BE-së, për të parë në mënyrë më konkrete interoperabilitetin me strukturat e DGTAXUD.

4.9 Sistemi i Regjistrimit dhe Identifikimit të Operatorit Ekonomik të UCC 2 – EORI2

Sistemi EORI2 paraqitet si versioni i përmirësuar i skemës ekzistuese të regjistrimit dhe identifikimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje të plotë me Kodin Doganor të Bashkimit (UCC). Qëllimi kryesor është të evoluojë sistemin aktual EORI për të përmbushur kërkesat moderne të digjitalizimit të proceseve doganore sipas UCC dhe të sigurojë ndërveprimin me platformat elektronike doganore në nivel të BE-së. Kjo nënkupton krijimin e një sistemi unik, të centralizuar dhe të harmonizuar regjistrimi për të gjithë operatorët ekonomikë (p.sh. shoqëri tregtare, persona fizikë që ushtrojnë veprimtari), si dhe personat e tjerë të përfshirë në veprimtaritë doganore, qofshin këta të Bashkimit apo të vendeve të treta.

Nëpërmjet EORI2, çdo subjekt pajiset me një identifikues të vetëm (numrin EORI), i cili njihet dhe përdoret njësoj nga të gjitha administratat doganore të shteteve anëtare, duke mundësuar komunikim elektronik të unifikuar dhe integrim në kohë reale në mbarë unionin doganor evropian.

Regjistrimi qendror i operatorëve: EORI2 funksionon si një sistem transevropian qendror për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të tjera që kryejnë veprimtari doganore. Çdo operator regjistrohet me një numër unik në këtë sistem, i cili shërben për identifikimin e tij në të gjitha procedurat doganore (import, eksport, tranzit, etj.) brenda territorit doganor të BE-së. Sistemi mbulon si operatorët e vendosur në BE, ashtu edhe operatorët e vendeve të treta, si dhe personat që nuk janë operatorë ekonomikë por angazhohen në çështje doganore në Union. Kjo qasje qendrore siguron një bazë të vetme të dhënash, ku të gjitha të dhënat e regjistrimit ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të unifikuar për gjithë territorin doganor të BE-së.

Sistemi EORI2 operon mbi parimin e një regjistrimi unik për subjekt, me ndarje të qartë të roleve midis autoriteteve kombëtare dhe atyre të BE-së. Regjistrimi fillestar dhe lëshimi i numrit EORI kryhet nga autoriteti doganor kombëtar kompetent për operatorët e vendosur në territorin e BE-së ky është autoriteti doganor i shtetit anëtar ku operon subjekti, ndërsa për operatorët jo të vendosur në BE është autoriteti i atij shteti anëtar ku kryhet veprimi i parë doganor. Pas lëshimit, numri EORI dhe të dhënat përkatëse ngarkohen në bazën



qendrore të EORI2, ku bëhen automatikisht të aksesueshme për të gjitha administratat doganore të vendeve anëtare. Kjo ndarje rolesh garanton që çdo subjekt regjistrohet vetëm një herë dhe identiteti i tij njihet njësoj kudo në BE, duke evituar dyfishimet dhe konfliktet midis regjistrimeve kombëtare.

EORI2 integron mekanizma të avancuar për sigurimin e cilësisë dhe konsistencës së të dhënave të regjistrimit. Sistemi kryen verifikime automatike dhe ndërshtetërore për të parandaluar regjistrime të dyfishta ose të pasakta.

Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit doganor: Një funksion kyç i EORI2 është shkëmbimi i menjëhershëm dhe i sigurt i informacionit të operatorëve midis të gjitha shteteve anëtare. Administratat doganore kombëtare kanë akses në bazën qendrore të EORI2 për të konsultuar ose verifikuar të dhënat e çdo subjekti, çka mundëson koordinim më të mirë gjatë kontrollit doganor dhe procedurave të përbashkëta.

Përdorimi në vendime të përbashkëta doganore: Numri unik EORI i gjeneruar nga sistemi EORI2 shërben si identifikues bazë në të gjitha sistemet e tjera doganore të përbashkëta brenda BE-së. Për shembull, në sistemin elektronik për menaxhimin e vendimeve doganore (*Customs Decisions Sistem – CDS*), çdo aplikim për autorizim apo vendim doganor nga një operator ekonomik kërkon që subjekti të ketë një EORI të vlefshëm.

Implementimi i EORI2 pritet të sjellë përfitime të shumta si për administratën doganore ashtu edhe për komunitetin e biznesit dhe vetë sistemet kombëtare në marrëdhënie me BE-në, duke rritur efektivitetin, transparencën dhe lehtësinë e operacioneve doganore:

Administrata doganore: Për administratën doganore, EORI2 ofron mjete të avancuara për kontroll dhe gjurmueshmëri më të mirë të aktiviteteve tregtare. Me një numër unik të përbashkët për çdo operator ekonomik, autoritetet mund të gjurmojnë lehtësisht historikun e deklarimeve dhe operacioneve doganore të atij subjekti në të gjitha pikat doganore dhe në statistikën e tregtisë brenda BE-së. Kjo rrit efikasitetin në zhdoganimin e mallrave dhe përmirëson kapacitetet e analizës së riskut dhe sigurisë, pasi të dhënat mbi shkeljet ose modelet e dyshimta mund të lidhen drejtpërdrejt me subjektin përkatës kudo në Union. Njëpërmjet aksesit të përbashkët në bazën qendrore të EORI2, administratat doganore kombëtare

shkëmbejnë informacion në kohë reale, gjë që forcon bashkëpunimin kundër mashtrimeve doganore, kontrabandës apo praktikave abuzive. Po ashtu, përdorimi i një standardi unik identifikimi lehtëson punën operationale të doganierëve, të cilët nuk kanë më nevojë të përshtatin sistemet për skema lokale identifikimi, por mbështeten tek një sistem i unifikuar evropian.

Operatorët ekonomikë: EORI2 sjell lehtësira të ndjeshme për subjektet tregtare që merren me importe/eksporte. Së pari, eliminohet barra e regjistrimeve të shumëfishta, një operator ekonomik regjistrohet vetëm një herë dhe merr një numër EORI të vlefshëm në mbarë BE-në, i cili pranohet nga të gjitha autoritetet doganore. Së dyti, proceset e deklarimit doganor bëhen më efikase: numri EORI përfshihet në çdo deklaratë (importi, eksporti, tranziti, etj.) dhe shërben për të thithur automatikisht të dhënat bazë të operatorit nga sistemi, duke shmangur rimbushjen manuale të formularëve me të dhëna që tashmë janë të regjistruara. Kjo kursen kohë dhe ul gabimet në plotësimin e deklaratave. Gjithashtu, operatorët ekonomikë përfitojnë nga trajtim i unifikuar në të gjithë BE-në: p.sh. nëse aplikojnë për një autorizim doganor (si procedurë e thjeshtuar, status AEO, vendim klasifikimi, etj.), numri i tyre EORI përdoret për t'i identifikuar në sistemin përkatës dhe për të marrë vendimin në mënyrë transparente dhe të gjurmueshme. Në tërësi, EORI2 ul kostot administrative për bizneset, përshpejton kohën e zhdoganimit dhe rrit sigurinë ligjore, pasi statusi dhe të dhënat e kompanisë janë të njohura paraprakisht nga doganat në çdo shtet anëtar.

Për Shqipërinë, integrimi i EORI2 sjell harmonizimin e plotë të sistemit të vet doganor me standardet e BE-së. Ky harmonizim përmirëson ndërveprimin elektronik midis sistemeve kombëtare dhe atyre evropiane. Sistemet tona doganore (p.sh. sistemi i deklarimit doganor, sistemi i tranzitit, ai i analizës së riskut, etj.) do të mund të lidhen drejtpërdrejt me bazën qendrore të BE-së për EORI, duke shkëmbyer automatikisht informacion mbi operatorët ekonomikë të regjistruar. Kjo do të thotë se një subjekt shqiptar me EORI do të njihet menjëherë nga sistemet e vendeve anëtare (dhe anasjelltas), çka lehtëson procedurat kur mallrat tona tranzitojnë ose hyjnë në BE, sepse palët doganore në kufi tashmë kanë të dhënat e operatorit. Një përfitim i rëndësishëm është edhe pjesëmarrja e



Shqipërisë në sisteme të përbashkëta doganore: adoptimi i EORI2 është parakusht për t'u lidhur me sisteme si ICS2 (Sistemi i Kontrollit të Importit në BE), NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit) apo platforma të tjera të BE-së, ku identifikimi unik i operatorëve është thelbësor. Duke qenë pjesë e këtyre rrjeteve, Shqipëria rrit kapacitetin e vet për monitorimin e flukseve tregtare ndërkufitare dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale me vendet fqinje dhe partnerët e BE-së. Në aspektin strategjik, këto përfitime e afrojnë vendin tonë me praktikat më të mira evropiane dhe rrisin besueshmërinë e administratës doganore shqiptare si një partnere e barabartë në rrjetin doganor të Unionit.

Objekti afatgjatë (2030) është që Shqipëria të ketë adoptuar plotësisht sistemin EORI2, duke e integruar atë në të gjitha hallkat e administratës doganore dhe legjislacionit kombëtar. Deri në vitin 2030 synohet që regjistrimi i çdo operatori ekonomik që vepron në Shqipëri të kryhet nëpërmjet EORI2, me harmonizim të plotë ndaj sistemit qendror evropian. Kjo do të sigurojë që numrat EORI të lëshuar nga autoritetet shqiptare të jenë në përputhje me formatin dhe rregullat e BE-së dhe të njihen automatikisht nga të gjitha vendet anëtare dhe sistemet e tyre doganore. Në këtë mënyrë, Shqipëria do të ketë arritur një shkallë të lartë ndëreveprimi me platformat e tjera doganore evropiane, përfshirë sistemet e deklarimit elektronik, menaxhimin e autorizimeve doganore dhe shkëmbimin e informacionit për qëllime sigurie dhe statistike. Realizimi i këtij objekti deri në vitin 2030 do të thotë që Shqipëria do të operojë si pjesë e hapësirës doganore digjitale të BE-së, duke plotësuar një nga kriteret kryesore teknike për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe duke garantuar lehtësira të barabarta tregtare për operatorët tanë ekonomikë në tregun e përbashkët evropian.

4.10 Mbikëqyrja e UCC 3 – SURV3

Surveillance 3 (SURV3) është sistemi qendror i Komisionit Evropian për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të importit dhe eksportit në nivel BE-je, me qëllim që të krijohet një pamje në kohë reale mbi tregtinë e mallrave. Komisioni nëpërmjet këtij sistemi i merr çdo ditë të dhënat e deklarimeve doganore nga të gjitha shtetet anëtare. Të dhënat nuk përdoren vetëm për statistika, por për zbatim operacional si për kuotat tarifore, kontrollin, etj.

Republika e Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim, është e detyruar ta zbatojë plotësisht këtë mekanizëm deri në datën e anëtarësimit. Baza e të dhënave duhet të jetë në gjendje të bashkëveprojë me infrastrukturën evropiane, duke respektuar kërkesat në lidhje me strukturën e të dhënave, standardizimin e të dhënave sipas EUCDM/TARIC, rregullat e përpunimit dhe transmetimit të të dhënave, etj. Kjo nënkupton harmonizimin e strukturës dhe standardeve të të dhënave, sigurimin e ndëreveprimi funksional midis sistemit kombëtar të deklarimit dhe SURV3, integrimin me TARIC, si dhe testimin dhe verifikimin paraprak të ndërfaqes në mjediset evropiane të testimit.

4.11 Fletët e Informacionit të UCC (INF) për Procedurat Speciale

Qëllimi dhe karakteristikat kryesore: Sistemi INF (*Information Sheets System*) mbështet administrimin e procedurave doganore të veçanta si përpunimi aktiv/pasiv, përdorimi i veçantë dhe magazinimi i përkohshëm. Qëllimi kryesor i INF-së është shkëmbimi standard i informacionit midis doganave kur mallrat lëvizin nga një regjim i veçantë në një tjetër, sidomos në rastet kur një pjesë e procesit ndodh jashtë një vendi (p.sh. importimi i një materiali në Shqipëri për përpunim aktiv dhe rieksporimi i produktit final në BE). Për raste të tilla, INF-ja siguron që nëse i njëjti mall importohet e më pas eksportohet, detyrimet importuese të mos paguhet dy herë për të njëjtin mall. Sistemi INF përbëhet nga dy komponentë: INF-STP (portali për operatorët ekonomikë) dhe INF-SP (moduli për zyrtarët doganorë). Përmes INF-STP, operatorët ekonomikë paraqesin kërkesat INF elektronike, ndërsa doganat përmes INF-SP aprovjnë kërkesat dhe gjenerojnë fletët INF përkatëse. Të dhënat kryesore që menaxhon sistemi INF përfshijnë: llogaritjen e borxhit doganor të përjashtuar, shumën e detyrimeve që do të ishin paguar pa regjimin e veçantë, kontrollin e kriterëve të ekuivalencës (në përpunim aktiv) dhe konfirmimin se produktet e eksportuara janë prodhuar nga materialet e importuara sipas autorizimit.

Ndikimi mbi biznesin: Për kompanitë shqiptare që shfrytëzojnë procedurat e përpunimit aktiv ose pasiv, sistemi INF do të thjeshtëzojë komunikimin me doganën dhe me partnerët në vendet e tjera. Aktualisht, shumë nga këto verifikime kryhen me shkëmbim dokumentesh në letër



(formularë INF), gjë që kërkon kohë dhe mund të shkaktojë vonesa në mbylljen e procedurave. Me sistemin e ri, një operator do të aplikojë *online* për autorizimin e një INF-je (p.sh. për të eksportuar produkte të përpunuara dhe më pas të rivendosë materialet në qarkullim të lirë pa taksa) dhe do të mund të monitorojë statusin e aplikimit në kohë reale. Kjo rrit sigurinë juridike për biznesin, pasi do të kenë një provë elektronike të aprovimeve dhe llogaritjeve doganore, të cilën mund ta arkivojnë lehtësisht. Për më tepër, koha e procedimit pritet të shkurtohet sepse doganat e vendeve të ndryshme do t'i shkëmbejnë të dhënat në mënyrë elektronike dhe të sinkronizuar. Kjo ul rrezikun e vonesave në rimbursimin e garancive apo kthimin e taksave kur procedurat e regjimeve të posaçme mbyllen. Në fund, një sistem INF-je funksional inkurajon më shumë kompani ta përdorin përpunimin aktiv për qëllime eksporti, pasi procedurat bëhen më të lehta dhe më transparente.

Sistemi INF do të zhvillohet sipas standardit unional dhe do të lidhet me sistemin INF central që operohet nga Komisioni Evropian. Kjo lidhje do të garantojë që Administrata Doganore të mund të shkëmbejnë informacion INF me doganat e shteteve anëtare menjëherë pas aderimit (ose edhe në kuadër të marrëveshjeve të tranzicionit gjatë statusit kandidat). Për shembull, nëse një mall importohet nën një regjim të posaçëm në Shqipëri dhe më pas eksportohet në BE, administrata doganore do të gjenerojë një fletë INF-je elektronike dhe do ta vërë në dispozicion të doganës së shtetit anëtar ku malli përpunohet ose konsumohet. Shqipëria do të ketë akses në fletët INF të lëshuara nga vendet e BE-së kur kjo nevojitet për të llogaritur detyrimet doganore. Implementimi i INF-së shihet nga BE-ja si hapi i parë drejt digjitalizimit të plotë të procedurave speciale nën UCC, ndaj integrimi i Shqipërisë në këtë sistem do të jetë një tregues i rëndësishëm i gatishmërisë së saj institucionale.

Përfitimet e pritshme nga zbatimi i sistemit INF janë bashkëpunim i rritur ndërmjet administratave doganore, monitorim dhe kontroll më efikas i procedurave speciale, dhe reduktim drastik i dokumentacionit në letër. Administrata doganore do të ketë një mjet modern për të ndjekur fluksin e mallrave nën regjime të posaçme dhe për të siguruar që detyrimet e pezulluara të paguhen vetëm nëse cenohen kushtet e autorizimit. Kjo ul mundësinë e abuzimeve apo shmangieve fiskale brenda këtyre

regjimeve. Nga ana tjetër, për komunitetin e biznesit, INF-ja sjell siguri dhe shpejtësi: kompanitë mund të planifikojnë operacionet e tyre, duke e ditur se aprovimet e nevojshme do të merren në kohë dhe se nuk do të përballen me interpretimin e rregullave, pasi sistemi unifikon praktikën. Sistemi INF do të jetë një komponent kyç i administratës doganore moderne, duke forcuar besimin reciprok midis doganave dhe operatorëve në zbatimin e regjimeve të posaçme.

4.12 Operatorët Ekonomikë të Autorizuar të UCC – AEO

Korniza Strategjike dhe Zbatimi në Praktikë

Programi i Operatorit Ekonomik të Autorizuar (AEO), në përputhje me modelin e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe lehtësimit të zinxhirit të furnizimit, përbën një komponent kyç në modernizimin dhe digjitalizimin e administratës doganore. Zbatimi i tij në Shqipëri ka nisur me përmbylljen e bazës së nevojshme ligjore dhe hartimin e Programit Kombëtar të AEO-ve, duke u konkretizuar me autorizimin e operatorëve të parë ekonomikë në vitin 2021.

Funksionaliteti i Sistemit IT AEO

Sistemi elektronik i AEO-ve është projektuar për të mbështetur të gjithë ciklin e menaxhimit të autorizimeve në mënyrë plotësisht digjitale. Ai i mundëson administratës doganore të:

- Pranojë dhe shqyrtojë aplikimet për statusin AEO;

- Lëshojë, pezullojë, revokojë ose tërheqë autorizimet përkatëse;

- Kryejë rivlerësime periodike, në përputhje me analizat e riskut dhe performancën e operatorit.

Gjithashtu, sistemi AEO mbështet komunikimin elektronik të sigurt dhe transparent ndërmjet Shërbimit Doganor, operatorëve ekonomikë dhe palëve të treta të përfshira, përfshirë trajtimin e çdo ngjarjeje që mund të ndikojë në vlefshmërinë e vendimit fillestar.

Funksionalitetet kryesore të sistemit përfshijnë:

- Transmetimin dhe përpunimin e aplikimeve elektronike AEO;

- Menaxhimin e dokumentacionit mbështetës dhe vendimeve doganore;

- Evidentimin dhe trajtimin e ngjarjeve të mëvonshme me ndikim në autorizim;



- Ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave, në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave dhe auditueshmërinë.

Zhvillimet e fundit dhe përputhshmëria me standardet e BE-së

Në kuadër të bashkëpunimit teknik dhe kontratës së mirëmbajtjes mes Administratës Doganore Shqiptare (ADSH) dhe UNCTAD, janë ndërmarrë hapa konkretë drejt integritetit të sistemit AEO në arkitekturën e përgjithshme të sistemit elektronik doganor *ASYCUDA World*. Aktualisht janë implementuar në ambientin testues:

- **Moduli i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO)** – për menaxhimin elektronik të autorizimeve në përputhje me standardet e BE-së;

- **Moduli për regjistrimin dhe identifikimin e operatorëve ekonomikë (EORI)** – i harmonizuar me sistemin e numrave të identifikimit të përdorur në Bashkimin Evropian, duke mundësuar identifikim unik të operatorëve për operacione doganore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektiva strategjike të programit AEO në Shqipëri

- Rritja e sigurisë së zinxhirit të furnizimit ndërkombëtar, përmes certifikimit të operatorëve të besueshëm;

- Lehtësimi i tregtisë dhe përshpejtimi i procedurave doganore për subjektet e autorizuar;

- Harmonizimi me praktikat më të mira të BE-së dhe përgatitja për njohjen e ndërsjellë të statusit AEO me vendet partnere;

- Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme të administratës doganore në fushën e menaxhimit të riskut dhe kontrollit të synuar.

4.13 Menaxhimi i Garancisë UCC (GUM)

GUM (Garancia sipas Kodit Doganor të Unionit) është sistemi elektronik i menaxhimit të garancive doganore të parashikuar nga *Union Customs Code* (UCC). Qëllimi i këtij sistemi është të mundësojë administrimin efektiv dhe uniform të garancive që mbulojnë borxhet doganore të mundshme, brenda gjithë territorit doganor të BE-së. Garancia doganore përkufizohet si një mbulim financiar për detyrimet doganore dhe pagesat e tjera që janë pezulluar përkohësisht; sipas legjislacionit të UCC-së, një garanci kërkohet si për detyrimet që kanë lindur ashtu edhe për ato që mund të lindin, përveç rasteve kur ligji parashikon përjashtime.

GUM-ja synon modernizimin e trajtimit të garancive, duke kaluar nga procedurat e

fragmentuara kombëtare në një sistem të integruar elektronik. Kjo nënkupton se një operator ekonomik mund të vendosë një garanci të vlefshme në mbarë Bashkimin Evropian, e cila njihet nga të gjitha administratat doganore. Komunikimi mbi garancitë realizohet plotësisht në rrugë elektronike, duke garantuar gjurmueshmëri, besueshmëri dhe integritet më të lartë të të dhënave doganore. Për Shqipërinë, implementimi i sistemit GUM ka për qëllim harmonizimin e praktikave kombëtare me ato të BE-së, në mënyrë që administrimi i garancive doganore të modernizohet dhe të përputhet me kërkesat e *acquis* të BE-së (Kapitulli 29 – Unioni Doganor) në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Sistemi GUM kryen funksionet bazë të administrimit dhe kontrollit të garancive doganore. Këto funksione përfshijnë:

- Regjistrimin e garancisë në sistem të të dhënave të garancisë së vendosur (loji, shuma referente, garantuesi, etj.), menjëherë sapo autorizohet garancia nga autoriteti doganor përkatës;

- Verifikimin e vlefshmërisë, kontrolli elektronik i ekzistencës dhe vlefshmërisë së garancisë sa herë që ajo përdoret për të mbuluar një detyrim doganor, duke siguruar se garancia është e ligjshme, e papërfunduar dhe e mjaftueshme;

- Monitorimin e shumës, ndjekja në kohë reale e shumës së angazhuar nga garancia për çdo deklaratë doganore, magazinim të përkohshëm apo procedurë tjetër doganore. Sistemi mban të dhëna mbi pjesën e garancisë që është përdorur dhe pjesën e mbetur të lirë, për të garantuar se shuma maksimale e garantuar nuk tejkalohet;

- Lirimin e garancisë, çlirimi ose zvogëlimi i garancisë pasi detyrimet doganore për të cilat ajo shërben si siguri janë likuiduar ose janë përmbushur kushtet për heqjen e saj.

Nëpërmjet këtyre funksioneve, GUM-i administron si garancitë individuale (për një deklaratë të vetme) ashtu edhe garanci globale që mbulojnë shumë operacione doganore. Përjashtim bën vetëm garancia për procedurën e transitit, e cila trajtohet veçmas nga sistemi NCTS. Sistemi i menaxhimit të garancive siguron, gjithashtu, regjistrimin e çdo ndryshimi (p.sh. rritje apo reduktim të shumës së garantuar, ose pezullim/anulim të garancisë) dhe njofton automatikisht zyrat doganore të interesuara nëse një garanci bëhet e pavlefshme apo e pamjaftueshme.



GUM-i sjell një sërë përfitimesh si për administratën doganore ashtu edhe për operatorët ekonomikë që përdorin garanci:

Për administratën doganore: Sistemi mundëson mbikëqyrje në kohë reale të alokimit dhe përdorimit të garancive në të gjitha pikat doganore, madje edhe për garancitë me vlefshmëri në disa shtete. Autoritetet doganore pajisen me mjetet e nevojshme për të identifikuar *menjëherë* çdo rast kur një garanci është e pavlefshme apo e pamjaftueshme për të mbuluar detyrimet e mundshme, kjo falë shpejtësisë së përpunimit dhe shkëmbimit elektronik të të dhënave midis zyrave doganore. Si rezultat, reduktohet ndjeshëm mundësia e mashtrimeve (p.sh. përdorimi i të njëjtës garanci në mënyrë abuzive në më shumë se një vend) dhe garantohen interesat financiarë të shtetit, duke siguruar mbulimin e plotë të detyrimeve doganore në çdo moment. Këto përmirësime rrisin efikasitetin fiskal, pasi të ardhurat doganore mbrohen dhe administrimi i tyre bëhet më i qëndrueshëm e transparent.

Për operatorët ekonomikë: GUM-i sjell thjeshtëzim dhe lehtësira në përmbushjen e detyrimeve doganore. Nëpërmjet konceptit të “garancisë globale”, një operator i autorizuar mund të depozitojë një garanci të vetme për të mbuluar disa operacione doganore njëkohësisht, edhe kur ato realizohen në vende të ndryshme brenda BE-së. Kjo ul ndjeshëm barrën administrative dhe kostot financiare, pasi eliminohet nevoja për të vendosur garanci të veçanta për çdo deklaram ose çdo shtet. Gjithashtu, procedurat e zhdoganimit bëhen më të shpejta, pasi sistemi elektronik u mundëson doganierëve të verifikojnë menjëherë nëse një garanci e vendosur nga një operator është ende e vlefshme dhe e mjaftueshme, duke eliminuar vonesat e mundshme që vijnë nga verifikimet manuale ose shkëmbimi i dokumenteve në letër. Kjo rrit eficiencën e procesit të zhdoganimit për bizneset, ul kohën e pritjes së mallrave në kufi dhe nxit qarkullimin më të shpejtë të tyre në treg.

Objektivi strategjik është që sistemi GUM të zbatohet plotësisht në Shqipëri deri në vitin 2030, në përputhje të plotë me udhërrëfyesin e BE-së (MASP-C) dhe me praktikat më të mira evropiane. Sipas programit të modernizimit doganor, komponentët qendrorë dhe kombëtarë të sistemit të menaxhimit të garancive do të jenë operacionalë.

Duke u mbështetur në këtë zhvillim, Shqipëria synon që deri në vitin 2030 të ketë përfunduar të gjithë hapat teknikë dhe ligjorë për implementimin e GUM Albania, duke ngritur komponentin e vet kombëtar të menaxhimit të garancive dhe duke e bërë atë plotësisht të ndërveprojë me sistemin qendror të BE-së.

4.14 Prova e Statusit të Unionit të UCC (PoUS)

PoUS (*Proof of Union Status*) është një sistem qendror i BE-së, i cili shërben për të provuar në mënyrë elektronike dhe të standardizuar statusin e mallrave si “mallra të Unionit”. Ky sistem zëvendëson provat tradicionale në letër (si dokumentet T2L/T2LF) dhe ofron një proces të unifikuar për autoritetet doganore dhe operatorët ekonomikë. Qëllimi i tij është të shmanget vendosja e detyrimeve doganore mbi mallra që tashmë gëzojnë statusin e Unionit, si dhe të garantohen procedura më efikase, transparente dhe të sigurta.

Përparësitë e këtij sistemi janë:

- Gjenerimi dhe verifikimi i provës elektronike të statusit në kohë reale;
- Integrimi i drejtpërdrejtë me sistemet e tjera të BE-së, si: NCTS, AES, CCI dhe INF, duke ruajtur zinxhirin e provës;
- Përdorimi i UUM&DS për menaxhimin e identiteteve të përdoruesve dhe për nënshkrimin digjital;
- Gjurmueshmëri e plotë për çdo provë, me një referencë unike të vlefshme në të gjitha vendet anëtare;
- Zbatimi i standardeve më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave, në përputhje me GDPR (*General Data Protection Regulation*).

Përfitimet për operatorët ekonomikë janë:

- Ulje e kostove administrative dhe shmangie e vonesave të shkaktuara nga dokumentacioni në letër;
- Siguri më e lartë juridike, pasi një provë e vetme elektronike do të njihet nga të gjitha autoritetet doganore të BE-së;
- Përshpejtim i procedurave doganore dhe rritje e besueshmërisë në tregtinë ndërkufitare.

Shqipëria do të përdorë drejtpërdrejtë sistemin qendror të BE-së për PoUS, pa nevojë për zhvillime shtesë kombëtare. Kjo do të realizohet përmes aktivizimit të llogarive për përdoruesit, ku administrata doganore do të ketë akses përmes rrjetit CCN2, ndërsa operatorët ekonomikë do të përdorin



sistemin UUM&DS, me kusht që ata të kenë tashmë akses në këto rrjete. Në këtë fazë, operatorët dhe administrata doganore në Shqipëri do të mund të përdorin funksionalitetet kryesore të sistemit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të unifikuar me ato të vendeve anëtare të BE-së.

4.15 COPIS (IPR enforcement)

Sistemi COPIS synon të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis mbajtësve të të drejtave dhe administratës kombëtare doganore. COPIS duhet të thjeshtojë dhe zvogëlojë ngarkesën e punës së administratës doganore dhe mbajtësve të të drejtave, duke përmirësuar bashkëpunimin në fushën e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale. COPIS duhet të jetë në gjendje të përdorë informacionin nga sistemi qendror evropian COPIS përmes një lidhjeje sistem-me-sistem.

Të dhënat personale të regjistruara në sistemet elektronike përpunohen për qëllime të zbatimit të legjislacionit doganor dhe akteve të tjera legjislative, duke marrë parasysh objektivat specifike të secilit prej sistemeve elektronike.

Shtetet anëtare sigurojnë që të dhënat e regjistruara në nivel kombëtar të korrespondojnë me të dhënat e regjistruara dhe që ato të mbahen të përditësuara.

Të dhënat e regjistruara në komponentët e sistemeve elektronike nga një operator ekonomik ose nga një person tjetër mund të aksesohen ose të përpunohen nga ai operator ekonomik, ose nga një person tjetër. Të dhënat në komponentin e ICS-së të komunikuar ose të regjistruara në ndërfaqen e përbashkët për tregtarët nga një operator ekonomik ose nga një person tjetër mund të aksesohen, ose të përpunohen nga ai operator ekonomik ose nga ai person tjetër. Të dhënat e regjistruara në sistemin ITO mund të përpunohen nga Shërbimi Doganor. Të dhënat e regjistruara në sistemin IDT nga një operator ekonomik ose një person tjetër mund të aksesohen ose të përpunohen nga ai operator ekonomik ose person. Ato mund të aksesohen nga Shërbimi Doganor në përputhje me pikën 31 të këtyre rregulloreve. Të dhënat nga sistemi i mbikëqyrjes mund të aksesohen dhe të përpunohen nga Shërbimi Doganor. Të dhënat e regjistruara në sistemin REX mund të aksesohen me qëllim zbatimin dhe monitorimin e regjimeve tregtare preferenciale nga Shërbimi Doganor.

Shërbimi Doganor është pronari i sistemeve për komponentët e përbashkët kombëtarë. Shërbimi Doganor mundëson sigurinë e përbërësve kombëtarë. Për këto qëllime, Shërbimi Doganor merr masat e nevojshme:

a) për të parandaluar çdo person të paautorizuar nga hyrja në mjediset e përdorura për përpunimin e të dhënave;

b) për të parandaluar futjen e të dhënave, si dhe çdo lloj konsultimi, modifikimi ose fshirjeje të të dhënave nga persona të paautorizuar;

c) për të zbuluar ndonjë nga aktivitetet e përmendura në pikat “a” dhe “b”.

Duke qenë se ADSH-ja disponon databazë kombëtare për mbajtësit e së drejtave dhe aplikimet për veprim, konkretisht sistemi Ines +, do të punohet në drejtim të zhvillimit të shërbimeve të internetit për t'i kaluar të dhënat në sistemin Copies, duke bërë të mundur shkëmbimin e informacionit me shtetet anëtare. Është parashikuar që të bëhet trajnimi i stafit dhe lidhja me sistemin e BE-së.

4.16 Moduli TARIC (*Tarif Integre Communautaire*)

Ky modul është një komponent thelbësor i përafritit të sistemeve kombëtare doganore me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e tarifave. Është një **bazë të dhënash e integruar** që mbulon të gjitha masat që lidhen me tarifën doganore të Bashkimit Evropian, si dhe rregulloret tregtare, bujqësore dhe legjislative që ndikojnë në tregtinë e mallrave me vendet e tjera. Zbatimi i tij është përgjegjësi e autoriteteve doganore, duke qenë një kusht i detyrueshëm për vendet që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian.

Për Republikën e Shqipërisë, arritja e përputhshmërisë me TARIC është një hap vendimtar drejt integritit në tregun e vetëm evropian. Deri në kohën e anëtarësimit, Republika e Shqipërisë duhet të jetë në gjendje të përdorë 7 modulet e mëposhtme:

1. Menaxhimi i të dhënave tarifore/TARIC (të dhënat kombëtare dhe të dhënat TARIC të BE-së);
2. TARIC *Web Consultation*;
3. Menaxhimi i TQS (moduli i kuotave);
4. Menaxhimi i EBTI (moduli i klasifikimeve Tarifore të Detyrueshme);
5. Moduli i nënsistemeve ITM (SMS, ECICS, ISPP);
6. Simulator CCN/CSI;



7. Ngarkimi dhe shfaqja e TARIC DB (Databaza e të dhënave të klasifikimeve).

Për këto module është zhvilluar sistemi ITMS, sipas kontratës “*Europe Aid/138143/DH/SER/AL*”, i cili do të popullohet me të dhënat të cilat do të merren nga sistemi elektronik doganor i cili pritet që të përditësohet me strukturën dhe të dhënat sikurse përdoren në BE. Në vijim të kësaj kontrate pritet edhe lidhja e një kontrate (nga ana e BE-së) për mirëmbajtjen e sistemit, e cila do të zgjasë për një periudhë njëvjeçare dhe në të cilën do të evidentohen problematikat pasi të krijohet mundësia e testimi në një server pranë strukturave të BE-së.

Këto module do të përdoren për:

- të marrë transmetime elektronike ditore të bazës së të dhënave TARIC të transmetuara nga Komisioni Evropian nëpërmjet rrjetit CCN/CSI;

- të përpunuar saktë informacionin nga skedarët e marrë për të përditësuar sistemet e tyre kombëtare të zhdoganimit në kohë reale, duke maksimizuar kështu shkallën e automatizimit të procesit të zhdoganimit;

- të integruar masat tarifore kombëtare në sistemin e vet TARIC (p.sh. normat e TVSH-së, akcizat), paralelisht me ato evropiane.

Këto module funksionojnë të lidhura me databazën qendrore të TARIC në Komisionin Evropian. Çdo shtet anëtar (apo kandidat për integrim) duhet të sigurojë sinkronizim ditor të të dhënave, për të pasur të njëjtat masa dhe tarifa të zbatueshme në kohë reale.

4.17 Moduli TQS (Kuotat Tarifore dhe Mbikëqyrja)

Moduli TQS (Kuotat Tarifore dhe Mbikëqyrja) është një sistem qendror elektronik për menaxhimin automatik të kuotave tarifore dhe mbikëqyrjen e tyre, që mbështet zbatimin e politikës tregtare të Bashkimit Evropian. Ky sistem siguron që operatorët ekonomik në të gjitha shtetet anëtare të trajtohen në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë. Moduli TQS funksionon në lidhje të ngushtë me bazën e të dhënave TARIC, e cila përfshin, përveç të tjerash, edhe kuotat tarifore preferenciale dhe autonome. Një kuotë tarifore është një sasi e kufizuar e një produkti të veçantë që gjatë një periudhe të caktuar kohore mund të importohet me tarifë doganore më të ulët se detyrimi doganor normal. Kufizimet mund të jenë për një ose më shumë vende origjine. Sistemi i kuotave të BE-së lejon zbatimin e tarifave doganore të reduktuara ose zero brenda kufijve të

sasive të përcaktuara (kuotat tarifore) dhe shpërndarja e këtyre sasive menaxhohet elektronikisht nga Komisioni Evropian përmes sistemit *Quota 2*.

Republika e Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim, është e detyruar ta zbatojë plotësisht këtë mekanizëm deri në datën e anëtarësimit. Sistemi kombëtar duhet të jetë në gjendje të bashkëveprojë me infrastrukturën evropiane, duke respektuar kërkesat në lidhje me strukturën e të dhënave, rregullat e përpunimit dhe transmetimit të të dhënave, protokollat e shkëmbimit të informacionit.

Funksionalitetet thelbësore të Modullit TQS:

- Transmetimi elektronik i kërkesave për kuota. Bazuar në kërkesat e vlefshme të importuesve, administrata doganore krijon në modulin e kuotave kërkesat për tërheqje kuotash dhe i dërgon pranë DG TAXUD;

- Pranimi dhe përpunimi i përgjigjeve për ndarjen e kuotave të marra elektronikisht nga Komisioni;

- Lidhja e përgjigjes së Komisionit me kërkesat specifike fillestare, për të lejuar zbatimin korrekt të nivelit tarifor.

Kërkesat teknike dhe të ndërveprimit:

Për të kryer këto funksione, sistemi kombëtar doganor duhet të jetë në gjendje të:

- mbledh të dhëna përkatëse nga deklaratat doganore të importit;

- të paraqesë kërkesat për ndarjen e kuotave në një format të standardizuar, përmes rrjetit të komunikimit CCN/CSI;

- të marrë dhe interpretojë mesazhet e përgjigjeve dhe skedarët e alokimit të gjeneruar nga DG TAXUD;

- të testohen plotësisht funksionalitetet operacionale në mjediset evropiane të testimi, përpara se të operojmë në mjedisin e kuotave të BE-së.

Zbatimi i Modullit TQS kërkon integrim efikas me sistemin kombëtar të deklarimit dhe me TARIC, në mënyrë që kuotat tarifore të alokohen dhe të mbikëqyren automatikisht, saktë dhe në kohë reale në të gjitha zyrtat doganore.

4.18 Moduli SMS (Sistemi i Menaxhimit të Specimeneve)

Sistemi IT për menaxhimin e sistemit të Specimeneve (Moduli SMS)

- Është modul që menaxhon specimenet e masave tarifore dhe jotarifore, pra mënyrën si këto masa paraqiten dhe shfaqen në sistem.



- Përdoret për të ruajtur, administruar dhe ripërdorur modele standarde (specimene) të përshkrimeve ligjore ose teknike të masave në TARIC.

- Mundëson konsistencë dhe uniformitet në mënyrën si paraqiten masat, p.sh.: tekste standarde për tarifa, ndalime, kufizime, përjashtime, preferenca tregtare, vula, etj.

- Siguron që shpjegimet dhe formulimet ligjore të jenë të njëjta për të gjitha vendet anëtare dhe të përditësohen lehtësisht kur ndryshon legjislacioni i BE-së.

Pra, ndryshe nga modulet e tjera, SMS në TARIC është si një bibliotekë/arkiv e specimeneve të teksteve dhe masave që përdoren për të ndërtuar në mënyrë të saktë bazën e të dhënave TARIC.

Ky është një modul sikurse modulet e tjerë që përfshihen në TARIC për të cilën është zhvilluar sistemi ITMS, në kuadër të projektit sipas kontratës me BE-në dhe që pritet që të krijohet mundësia e testimit në ambientet e testimit të serverëve pranë BE-së, për të parë në mënyrë më konkrete interoperabilitetin me strukturat e DGTAXUD.

4.19 Moduli ECICS (Inventari Doganor Evropian i Substancave Kimike)

Moduli për Inventarin Evropian të Substancave Kimike (Moduli ECICS) është “Moduli kimik” i TARIC-ut, një inventar digjital i substancave kimike për të lehtësuar klasifikimin tarifor dhe përputhjen me legjislacionin e BE-së.

- Baza e të dhënave për substancat kimike që përdoret nga doganat dhe bizneset;

- Ndihmon për klasifikimin tarifor të substancave kimike në NKM (Nomenklaturën Kombinuar) dhe TARIC;

- Jep informacione të detajuara për:

- emrin kimik (IUPAC, emrat tregtarë, sinonimet);

- numrin CAS dhe numra të tjerë identifikues;

- kodet e NC/TARIC ku klasifikohet substancë;

- informacione shtesë ligjore (masa kufizuese, ndalime, preferenca, etj.).

Funksioni praktik:

- ECICS përdoret nga zyrtarët doganorë, laboratorët dhe operatorët ekonomikë për të siguruar që substancat kimike deklarohen saktë në doganë;

- Shërben si referencë e unifikuar për të shmangur klasifikime të gabuara të kimikateve;

- Është i lidhur me TARIC, sepse garanton që klasifikimi tarifor i substancave kimike të reflektohet drejtpërdrejt në masat tarifore dhe jotarifore të BE-së;

Ky është një databazë që përfshihet në TARIC, pjesë e sistemi ITMS, në kuadër të projektit sipas kontratës me BE-në dhe që pritet që të krijohet mundësia e ndërveprimit dhe testimit me sistemin e BE-së, për të parë në mënyrë më konkrete interoperabilitetin me strukturat e DGTAXUD.

4.20 NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit)

Ky projekt i mbështetur nga Banka Botërore ka nisur në mars 2020. Lidhur me paketën e prokurimit “Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Kontrolli i Cilësisë për Zbatimin e plotë të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit (NCTS) në Shqipëri” me nr. WBTF-ALB-121D, datë 3.6.2022, u zgjodh konsulenti fitues dhe u kontraktua nga CFCU-ja.

Në lidhje me procedurën e prokurimit “Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit plotësisht në përputhje me EU-NCTS”, ref. nr. WBTF-ALB-121B”, kompania fituese (NETCompany-Intrasoft) u zgjodh dhe u kontraktua nga CFCU-ja.

Zbatimi i NCTS-së synon standardizimin e proceseve të tranzitit doganor në vendet që janë palë e Konventës së Tranzitit të Përbashkët (CTC).

Aktualisht, statusi i aktivitetit që lidhet me zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të Përbashkët të Tranzitit, NCTS P5, është:

Banka Botërore/Ministria e Financave ka nënshkruar kontratën me kompaninë fituese “Net Company/Intrasoft”, në qershor të vitit 2024, me tenderimin e vetëm të produktit Soft, pasi pajisjet dhe rrjeti i produkteve Hard do të sigurohen nga institucioni i AKSHI-t.

Në bashkëpunim me kompaninë që do të zbatojë sistemin NCTS, me konsulencën e një eksperti ndërkombëtar dhe PIU-n (Njësia e Zbatimit të Projektit), është hartuar dokumenti me specifikimet teknike kombëtare, dhe administrata doganore është duke përgatitur dokumentin NCTS P5 të NPP-së “Plani i Projektit Kombëtar” për ta dërguar atë në DG TAXUD.

Gjithashtu, administrata doganore ka miratuar urdhrin për ngritjen e grupit të punës që do të marrë pjesë në këtë proces gjatë të gjithë fazës së zbatimit.

Kompania zbatuese për implementimin e sistemit ka nisur me instalimin në mjedisin test të



sistemit ERMIS (NCTS) dhe është në kontakt të vazhdueshëm me pjesëtarët e grupit të punës për NCTS-në, AKSHI-n, PIU-n dhe ekspertin ndërkombëtar.

Kompania përgjegjëse për implementimin ka mbaruar instalimin e infrastrukturës, zhvillimin e artefakteve dhe krijimin e *user-ave* në mjedisin test dhe pritet prezantimi i DEMOs në ambientet e doganës gjatë muajit shtator 2025.

Për sa i përket versionit të termave të referencës/specifikimet teknike për *upgrade* të fazës 6 në opsionin OPT-Out, janë përgatitur nga PIU të miratuara nga Banka Botërore, termat e referencës të cilat janë miratuar nga administrata doganore dhe AKSHI.

Në lidhje me NCTS faza 6, Banka Botërore ka miratuar financimin në formë Granti për implementimin e kësaj faze sipas kërkesës së DPD-së. Gjithashtu, ka mbaruar faza e përgatitjes së termave të referencës/specifikimeve teknike, të cilat janë miratuar nga DPD-ja dhe AKSHI, dhe pritët miratimi nga projekt menaxheri. Më pas, CFCU-ja në Ministrinë e Financave do të fillojë negociatat me kompaninë për fazën përfundimtare.

4.21 Sistemi i Automatizuar i Eksportit (AES)

AES-ja do të mundësojë digjitalizimin e plotë të procedurave të eksportit nga Shqipëria, në përputhje me kërkesat e UCC-së. Objektivi kryesor i AES-së është të sigurojë që transaksionet e eksportit të nisura nga Shqipëria të mund të përfundohen në mënyrë elektronike në një shtet tjetër, pa pasur nevojë për ridërgimin e të dhënave. Sistemi do të mbështesë lloje të ndryshme deklaratah eksporti, nga deklaratat standarde tek ato të thjeshtësuara ose plotësuese, përfshirë para paraqitjen dhe do të përfshijë procedura të thjeshtuara dhe zhdoganim të centralizuar të eksportit sipas parashikimeve të UCC-së. Komponentët kryesorë të AES-së do të jenë: platforma kombëtare e tregtarëve për dorëzimin e deklaratave, sistemi kombëtar i përpunimit të deklaratave të eksportit, si dhe ndërfaqet e nevojshme me sisteme të tjera (p.sh. NCTS për tranzitin dhe EMCS – sistemi për monitorimin dhe kontrollin e mallrave të akcizave).

Me AES-në, eksportuesit shqiptarë do të kenë një proces më të shpejtë dhe të parashikueshëm për daljen e mallrave nga territori doganor. Deklaratat doganore të eksportit do të paraqiten elektronikisht dhe do të procesohen në mënyrë të automatizuar,

duke ulur gabimet njerëzore dhe duke eliminuar nevojën për dorëzim fizik dokumentesh. AES-ja do të sigurojë komunikim të menjëhershëm midis doganës së eksportit dhe doganës së daljes, gjë që ul vonesat në pikat kufitare dhe u mundëson operatorëve ekonomikë menaxhim më efikas të dërgesave dalëse. Gjithashtu, integrimi i kontrollit doganor në sistem ul kontaktin e drejtpërdrejtë të biznesit me zyrtarët doganorë dhe kështu redukton potencialin për praktika korruptive.

Sistemi AES shqiptar do të integrohet me rrjetin e sistemeve të eksportit të BE-së, në mënyrë që të shkëmbejë automatikisht mesazhet elektronike me administratat doganore të shteteve anëtare. Kjo do të mundësojë njohjen reciproke të deklaratave të eksportit dhe rezultateve të kontrollit: p.sh. një deklaratë eksporti e paraqitur në Shqipëri do të njihet në pikat e daljes në BE dhe e kundërta. AES-ja do të implementohet sipas specifikimeve teknike të Komisionit Evropian, duke siguruar ndërveprim teknik 100% me sistemet qendrore të BE-së për eksportin. Në veçanti, AES-ja do të ketë ndërfaqe kombëtare me NCTS-në dhe sistemin evropian të akcizave (EMCS), ashtu që të gjitha formalitetet e daljes të kryhen sipas standardeve evropiane.

Zbatimi i AES-së do të sjellë shpejtësi, siguri dhe transparencë më të madhe në procedurat e eksportit. Sistemi i unifikuar do të mundësojë gjurmim elektronik të çdo deklarate eksporti nga momenti i paraqitjes deri në daljen fizike të mallrave, duke siguruar një audit të plotë dhe duke lehtësuar kontrollet e mëvonshme. AES-ja do të ndihmojë edhe në mbledhjen e saktë të të ardhurave doganore, pasi do të minimizojë gabimet në deklarim dhe evazionin fiskal. Për më tepër, ky sistem është parakusht për zbatimin e zhdoganimit të centralizuar në të ardhmen, ku një operator mund të kryejë të gjitha formalitetet doganore të eksportit në një pikë të vetme pavarësisht vendndodhjes së mallrave.

4.22 Zhdoganimi i Centralizuar i UCC për Import (CCI)

Zhdoganimi i Centralizuar përfaqëson një nga thjeshtimet më të rëndësishme të Kodit Doganor të Bashkimit (UCC), duke u mundësuar operatorëve ekonomikë të paraqesin deklaratën doganore pranë zyrës doganore mbikëqyrëse në një shtet anëtar, edhe pse mallrat paraqiten fizikisht në një zyrë doganore të një shteti tjetër anëtar. I gjithë komunikimi zhvillohet përmes zyrës doganore



mbikëqyrëse, e cila vepron si një pikë e vetme kontakti (*one stop shop*), duke koordinuar procesin e deklarimit dhe lëshimit fizik të mallrave në bashkëpunim me zyrat e tjera doganore të përfshira.

Qëllimi kryesor i këtij sistemi është të mundësojë një funksionim plotësisht të automatizuar të procesit të zhdoganimit të qëndruar për importet në nivel evropian. Sistemi garanton shkëmbim të vazhdueshëm elektronik të të dhënave ndërmjet zyrave doganore të përfshira, duke reduktuar ndjeshëm barrën administrative për administratat doganore të shteteve anëtare gjatë përpunimit të deklaratave të importit.

Fillimisht, sistemi do të lejojë përpunimin e automatizuar të deklaratave standarde doganore për mallrat që paraqiten fizikisht në zyrat doganore të një ose më shumë shteteve anëtare, për procedurat e mëposhtme:

- Çlirim për qarkullim të lirë;
- Magazinimi doganor;
- Përpunimi aktiv,
- Përdorimi përfundimtar.

Zbatimi i kësaj strategjie do t'u ofrojë kompanive përfitime konkrete, si:

- Zhdoganim më i shpejtë i mallrave të importuara;
- Reduktim i procedurave doganore, duke shmangur nevojën për procedura transiti;
- Ulja e ngarkesës administrative, përmes një pike të vetme kontakti;
- Kursim kostosh, përmes proceseve të centralizuara, rritje të transparencës dhe përputhshmërisë;
- Rritje e konkurrueshmërisë në tregun global, përmes operacioneve të thjeshtuara dhe digjitale.

4.23 Njoftimi i mbërritjes, njoftimi i prezantimit dhe magazinimi i përkohshëm AN/PN/ TS sipas UCC

Tre komponentë përfaqësojnë fazat fillestare të procesit doganor të importit sipas Kodit Doganor të Unionit (UCC).

- Njoftimi i Mbërritjes (*Arrival Notification, AN*) është njoftimi zyrtar që bën transportuesi për mbërritjen e mjetit transportues në territorin doganor. Qëllimi i AN-së është të informojë menjëherë autoritetet doganore se mjeti i transportit ka mbërritur në pikën e hyrjes, në mënyrë që të fillojnë procedurat e kontrollit dhe shkëmbimit të të dhënave të nevojshme;

- Njoftimi i Prezantimit (*Presentation Notification, PN*) pason njoftimin e mbërritjes dhe konsiston në paraqitjen e mallrave tek dogana sapo ato shkarkohen ose vihen në dispozicion në vendin e hyrjes. Me këtë hap, deklarohet zyrtarisht se mallrat janë vënë nën mbikëqyrje doganore dhe janë gati për t'u nënshtruar kontrolleve ose procedurave të mëtejshme;

- Magazinimi i Përkohshëm (*Temporary Storage, TS*) është statusi doganor i mallrave nga momenti i prezantimit tek dogana deri sa ato t'i nënshtrohen një procedurë doganore përfundimtare (p.sh. deklarim për qarkullim të lirë, tranzit, magazinim doganor, etj.) ose riekспорт. Gjatë kësaj periudhe, mallrat qëndrojnë në një hapësirë të autorizuar nën mbikëqyrjen e doganës. Ky regjim siguron që asnjë mall i hyrë në territorin doganor të mos i shmanget kontrollit, mallrat mbeten nën mbikëqyrje doganore derisa të zhdoganohen ose të dalin sërish jashtë vendit.

Këta tre komponentë (AN, PN, TS) janë të ndërlidhur dhe së bashku garantojnë një trajtim të unifikuar të mallrave në hyrje duke harmonizuar shkëmbimin e të dhënave mes biznesit dhe doganës sipas kërkesave ligjore të UCC-së.

Njoftimi i mbërritjes shërben për njoftimin e menjëhershëm elektronik të autoriteteve doganore mbi mbërritjen e një ngarkese. Kjo ju mundëson doganierëve të kenë informacion paraprak dhe të lidhin këtë njoftim me deklaratën përmbledhëse hyrëse (ENS) të dorëzuar më parë për qëllime sigurie. Përmes sistemeve, shkëmbimi i informacionit kryhet automatikisht dhe regjistron njoftimin e mbërritjes së mjetit transportues dhe e shpërndan atë tek autoritetet përkatëse.

Njoftimi i prezantimit ka funksionin të deklarojë zyrtarisht prezantimin fizik të mallrave në zyrën doganore të hyrjes. Ky njoftim (i cili mund të jetë një mesazh elektronik i veçantë ose i kombinuar me deklaratën e magazinimit të përkohshëm) përmban të dhëna identifikuese mbi mallrat dhe vendndodhjen ku ato paraqiten.

Pas këtij hapi, sistemi gjeneron një Deklaratë për Magazinim të Përkohshëm (*Temporary Storage Declaration, TSD*), e cila përmban të dhënat, detaje të mallrave gjatë qëndrimit të tyre nën regjim të përkohshëm. Kjo deklaratë shërben si bazë për administrimin e mallrave në magazinën e përkohshme dhe lidh të dhënat e ENS-së me deklarimin final të mallrave. Gjatë periudhës së



magazinimit të përkohshëm, funksioni kryesor i sistemit TS është të monitorojë statusin e mallrave (p.sh. afatet kohore, lëvizjet midis magazinave të autorizuar) dhe të sigurojë që brenda afatit ligjor të merren veprimet e duhura (deklarimi ose rieksporimi). Këto funksione sigurojnë gjurmueshmëri të plotë të mallrave nga mbërritja deri tek zhdoganimi.

Implementimi i AN/PN/TS sipas UCC-së sjell përfitime të shumta si për administratën doganore, ashtu edhe për komunitetin e biznesit:

- Për autoritetet doganore: Siguron kontroll më të mirë dhe menaxhim risku që në momentin e hyrjes së mallrave. Duke marrë njoftimin elektronik të mbërritjes dhe të prezantimit në kohë reale, doganat mund t'i krahasojnë këto të dhëna me analizat e riskut të kryera mbi deklaratat përmbledhëse hyrëse (ENS). Kjo rrit efektivitetin në zbulimin e mallrave me risk të lartë. Menaxhimi i inventarit të mallrave në magazinat e përkohshme bëhet më transparent, pasi sistemi ofron pasqyrë në çdo kohë se cilat mallra ndodhen ku dhe nën përgjegjësinë e kujt. Kjo zvogëlon mundësinë e humbjes, zhdukjes apo manipulimit të mallrave nën mbikëqyrje. Në aspektin administrativ, automatizimi i këtyre proceseve redukton ngarkesën burokratike: njoftimet elektronike zëvendësojnë dokumentet në letër, minimizojnë gabimet njerëzore dhe përshpejtojnë procedurat e pranimit të mallrave. Për më tepër, harmonizimi me standardet e BE-së rrit bashkëpunimin ndërkuftar, pasi Shqipëria si vend kandidat do të shkëmbejë të dhëna në format të standardizuar me sistemet doganore të vendeve anëtare, duke lehtësuar procedurat e transitit dhe kontrollit të përbashkët.

- Për operatorët ekonomikë: Një proces i qartë dhe i digjitalizuar i njoftimit të mbërritjes/prezantimit ul pasigurinë dhe vonesat për importuesit. Transmetimi elektronik i të dhënave i jep mundësi transportuesve dhe agjentëve doganorë të kryejnë formalitetet edhe përpara mbërritjes fizike të mallrave (në disa raste, p.sh. deklarata përmbledhëse dhe ajo e magazinimit mund të dorëzohen paraprakisht). Kjo sjell kohë zhdoganimi më të ultë, pasi autoritetet kanë marrë tashmë informacionin dhe mund të marrin vendim për lirim ose kontrollin e mallrave menjëherë sapo ato mbërrijnë. Bizneset përfitojnë, gjithashtu, nga transparenca dhe parashikueshmëria më e madhe, pasi sistemi mundëson gjurmimin e statusit të

ngarkesës (p.sh. “njoftuar si e mbërritur”, “prezantuar në doganë”, “në magazinim të përkohshëm”) në kohë reale. Kjo i ndihmon ata të planifikojnë më mirë zinxhirin logjistik dhe të shmangin kosto të panevojshme magazinimi.

- Zbatimi i AN, PN dhe TS në Shqipëri kërkon zhvillimin e një sistemi elektronik kombëtar që është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të BE-së. **Së pari**, të dhënat që do të shkëmbehen duhet të jenë në formatin e harmonizuar sipas modelit të të dhënave doganore të BE-së (EU CDM). UCC-ja dhe aktet nënligjore përcaktojnë standardin e të dhënave për secilin njoftim/deklaratë (AN, PN, Deklarata e Magazinimit) në shtojcën B të akteve deleguese dhe zbatuese. Kjo do të thotë se sistemi kombëtar shqiptar duhet të mbështesë *dataset*-in e detyrueshëm (p.sh. identifikimi i transportuesit, mjeti dhe numri i udhëtimit, vendi i mbërritjes, përshkrimi i mallrave, sasia, peshat, etj.) për AN/PN/TS, sipas versionit më të fundit të legjislacionit të BE-së. **Së dyti**, kërkohet ndërtimi i ndërfaqeve elektronike për komunikim mes palëve: bizneset (p.sh. kompanitë ajrore, detare, agjentët doganorë) duhet të kenë mundësi të paraqesin njoftimet përmes portalit elektronik, ndërsa autoritetet doganore të pranojnë, të përpunojnë dhe të kthejnë përgjigje automatike (pranim, refuzim, udhëzime kontrolli).

ADSH-ja do të synojë që brenda afatit kohor 2030 të ketë realizuar plotësisht implementimin e sistemit AN/PN/TS në përputhje me UCC-në, si pjesë e përgatitjeve për anëtarësim në BE dhe integrim në regjimin e përbashkët doganor. Brenda këtij afati kohor, sistemi shqiptar për AN/PN/TS duhet të ketë kaluar testet e konformitetit me Komisionin Evropian.

4.24. Sistemi Kombëtar i Importit të UCC (NIS)

NIS-i për importet është një sistem elektronik i zhdoganimit të mallrave në import, i cili do të zëvendësojë sistemet aktuale dhe praktikat manuale. Ky sistem do të zbatojë të gjitha proceset dhe formalitetet doganore që lidhen me importin sipas kërkesave të UCC-së dhe Modelit të të Dhënave Doganore të BE-së (EU CDM – *EU customs data model*). NIS-i do të mbështesë formate të ndryshme deklaratash importi (standarde, të thjeshtuara, të parambërritjes, me regjistrim në evidencat e deklaruesit, deklarata plotësuese) dhe do të mundësojë përpunimin e tyre elektronik në Sistemin Doganor Shqiptar. Në kuadrin e NIS-it do të



zhvillohen funksionalitete specifike për procedurat e veçanta të importit (magazinimi doganor, përdorimi i veçantë, përpunimi aktiv, etj.) duke përdorur strukturat e të dhënave të harmonizuara me EUCDM-në.

Për importuesit dhe agjentët doganorë, NIS-i do të ofrojë një mjedis unik elektronik për dorëzimin dhe ndjekjen e deklaratave të importit. Koha mesatare e përpunimit të një deklarate do të ulet ndjeshëm falë automatizimit, çka do të thotë çlirimin më të shpejtë të mallrave pas mbërritjes. Sistemi do të minimizojë gabimet gjatë deklarimit, pasi do të integrojë kontrolle automatike të saktësisë dhe plotësisë së të dhënave. Gjithashtu, NIS-i pritet të ketë ndikim pozitiv në mjedisin e biznesit duke ulur barrën administrative: operatorët ekonomikë do të mund të rigjenerojnë të dhëna nga deklaratat e mëparshme, të komunikojnë elektronikisht me doganën për çdo sqarim, dhe të marrin njoftime automatike për vendimet e doganës (p.sh. për zhdoganim ose kontroll fizik).

Sistemi i ri i importit do të konceptohet që në fillim për përputhshmëri me sistemet homologe të shteteve anëtare. Kjo do të sigurojë që, kur Shqipëria të aderojë në BE, NIS-i të mund të lidhet pa pengesa me platformën e zhdoganimit të centralizuar për importin (CCI) dhe me rrjetin e sistemeve kombëtare të importit të vendeve të tjera. Për më tepër, NIS-i do të jetë i ndërveprueshëm me sistemet e menaxhimit të riskut dhe sigurisë si ICS2 dhe CRMS, duke shkëmbyer të dhënat relevante (p.sh. deklaratat përmbledhëse të hyrjes, rezultatet e analizave të riskut, etj.). Kjo ndërveprimësi do të garantojë që të dhënat e importit të Shqipërisë të jenë pjesë e sistemit të unifikuar evropian, duke mundësuar kontrolle të sinkronizuara dhe njohjen e ndërsjellë të rezultateve.

AIS-i do të krijojë një platformë moderne, të sigurt dhe me shkallëzueshmëri të lartë për trajtimin e importeve. Avantazhi kryesor i përdorimit të këtij sistemi është centralizimi i informacionit doganor i të dhënave të deklarimit, pagesave, kontrollet dhe vendimet doganore do të ruhen në mënyrë të strukturuar dhe do të jenë lehtësisht të aksesueshme për analiza dhe raportim. Sistemi do të ofrojë raporte automatike për performancën (p.sh. kohën mesatare të zhdoganimit) dhe do të lehtësojë auditimin elektronik të operacioneve. Nga pikëpamja strategjike, NIS-i përgatit Shqipërinë për zbatimin e Zhdoganimit të Centralizuar (që pritet të

zbatohet në nivel BE-je) ku importuesit e besuar mund të deklarojnë mallrat në doganën e vendbanimit ndërsa mallrat paraqiten fizikisht në një shtet tjetër.

4.25 *Integrated Tariff Management Sistem (ITMS)*

Përmirësimi i sistemit kombëtar ITMS të pajtueshme me sistemin ITMS të BE-së (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave), me qëllim integrimin e tyre, për të shkëmbyer informacion tarifor midis Komisionit të BE-së dhe Shërbimit Doganor të Republikës së Shqipërisë; duke përdorur të njëjtat kode/dokumente/rregullore të BE-së, duke ruajtur përkohësisht tarifatat e vendit tonë. Në këtë mënyrë, Shqipëria mund të ketë qasje në informacionin doganor të BE-së dhe, në të njëjtën kohë, të vazhdojë të zbatojë tarifatat dhe masat tarifore dhe jotarifore nacionale deri në aderimin e plotë.

Sistemi ITMS duhet të përmbajë komponentët e mëposhtëm në përputhje me specifikimet teknike të BE-së, duke u bazuar në:

1. Qëllimin kryesor

- Një sistem kombëtar i menaxhimit të tarifave (ITMS) që është plotësisht i pajtueshëm me standardet dhe praktikën e BE-së;

- Integrimi i sistemit kombëtar në rrjetin ITMS të BE-së, për të siguruar shkëmbim të dhënash në kohë reale, transparencë dhe lehtësim të tregtisë ndërkufitare.

2. Objektivat specifikë

1. Harmonizimi i legjislacionit dhe procedurave tarifore me Kodin Doganor të BE-së;

2. Një platformë IT-je që mbështet proceset e menaxhimit të tarifave dhe përputhshmërinë me direktivat e BE-së;

3. Sigurimi i interoperabilitetit teknik (formate të dhënash, protokolle sigurie, standarde komunikimi);

4. Trajnimi i stafit doganor dhe palëve të interesuara për përdorimin efektiv të sistemit;

5. Reduktimi i burokracisë dhe lehtësimi i tregtisë për bizneset.

3. Shtyllat kryesore të strategjisë

a) Harmonizimi ligjor dhe institucional:

- Përditësimi i akteve ligjore kombëtare në përputhje me *Union Customs Code (UCC)* të BE-së;

- Riorganizimi i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e tarifave;

- Përfshirja e autoriteteve të tjera publike që lidhen me tregtinë ndërkombëtare (tatimet, bujqësia, shëndetësia, etj.);



b) Zhvillimi teknologjik:

- Analizë e sistemit ekzistues IT në dogana;
- Sigurimi i ndërveprimit së sistemit ITMS me BE-në sipas kërkesave të tyre (standardet e sigurisë, aksesit dhe shkëmbimit të të dhënave);
- Zbatimi i moduleve për: klasifikimin tarifor, origjinën e mallit, llogaritjen e detyrimeve, menaxhimin e riskut;
- Testime pilot dhe certifikim nga BE-ja për pajtueshmëri;

c) Interoperabiliteti me ITMS të BE-së:

- Zbatimi i standardit për shkëmbim të dhënash me BE-në;
- Lidhja me sistemin TARIC të BE-së (*Tariff Integrated Community*);
- Integrim me databazat e tjera të BE-së (EORI, BTI, CDS, etj.);

d) Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve:

- Programe trajnimi për zyrtarët doganorë, bizneset dhe përkthyesit tariforë;
- Hartimi i udhëzuesve praktikë për përdoruesit e sistemit;
- Fushata ndërgjegjësimi për operatorët ekonomikë;

4. Rezultatet e pritshme

- Integrim i plotë i sistemit kombëtar ITMS në sistemin e BE-së;
- Reduktim i kostove dhe kohës për operatorët ekonomikë;
- Rritje e transparencës dhe luftë më efektive kundër mashtrimeve doganore;
- Përmirësim i klimës së biznesit dhe lehtësim i tregtisë ndërkombëtare;

KAPITULLI V

STRATEGJITË E ZBATIMIT DHE KPI-ve
(KONTROLLI I PERFORMANCËS SË
INDIKATORËVE)

5.1 Masa konkrete të implementimit

Zbatimi i strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor në Shqipëri do të zhvillohet në dy etapa të mëdha: **2025–2029** (faza e përgatitjes, ndërtimit dhe testimit) dhe **2030** (faza e përfundimit dhe certifikimit për integrim në BE).

Faza e parë: Përgatitja, zhvillimi dhe integrimi (2025–2029)

Në këtë periudhë do të realizohen këto masa kryesore:

- **Hartimi i planeve teknike dhe ligjore:** përafrimi i Kodit Doganor Shqiptar me Kodin Doganor të BE-së (UCC), miratimi i akteve nënligjore për proceset elektronike dhe për qeverisjen e të dhënave doganore.

- **Zhvillimi i infrastrukturës IT:** modernizimi i qendrave të të dhënave dhe rrjeteve ekzistuese për të hostuar sistemet doganore, garantimi i kapaciteteve të plota të ruajtjes dhe sigurisë, si dhe vendosja e mekanizmave të *backup*-it dhe *disaster recovery* për të siguruar vazhdimësi operacionale.

- **Zhvillimi i sistemeve kombëtare të ndërveprueshme me BE-në:** implementimi i sistemeve/ moduleve kombëtare të përcaktuara në strategji si sistemi NCTS, NSW, etj.

- **Testime dhe pilotime:** testim i integritetit me sistemet e BE-së dhe me operatorët ekonomikë vendas; zhvillimi i projekteve pilot në pikat doganore kryesore.

- **Trajnimi i stafit:** ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve doganorë dhe stafit IT, në fusha si: siguria kibernetike, menaxhimi i riskut dhe përdorimi i sistemeve të reja digjitale.

- **Përfshirja e biznesit:** krijimi i platformave të reja të shërbimit elektronik (p.sh. integrimi në *e-Albania* dhe portale të dedikuara për operatorët ekonomikë), si dhe zhvillimi i mekanizmave për komunikim të shpejtë dhe transparent me komunitetin e biznesit.

Faza e dytë: Konsolidimi dhe gatishmëria për anëtarësim në BE (2030)

- **Funksionimi i plotë i sistemeve** të gjitha modulet doganore kombëtare të ndërveprueshme me BE-në do të jenë në përdorim të plotë dhe të unifikuar.

- **Certifikimi i përputhshmërisë** nga Komisioni Evropian për të garantuar se Shqipëria është gati për t'u integruar në arkitekturën digjitale doganore të BE-së.

- **Vlerësim përfundimtar i progresit** auditim i jashtëm mbi arritjen e KPI-ve dhe analiza e qëndrueshmërisë institucionale, teknologjike dhe financiare.

- **Deklarimi “Sistem Ready for EU Accession”:** Shqipëria do të shpallë përgatitjen për integrimin e plotë në *Union Customs Code (UCC) IT Environment*, duke plotësuar të gjitha kriteret për anëtarësim.



5.2 Tabela e treguesve kryesorë të performancës (KPI)

Objektivi Strategjik	KPI	Viti bazë (2024)	Viti i synuar	Institucioni përgjegjës
Zhvillimi dhe integrimi me sistemet e BE-së	Përqindja e sistemeve të BE-së të implementuara dhe funksionale	Aktualisht janë testuar (18%) ose 4 sisteme që pritet të hidhen live	≥ 90% deri në 2030	Dogana/AKSHI
Përmirësimi i efikasitetit	Koha mesatare e zhdoganimit (në orë)	90 min.	Uljë me 30% deri në 2028	Dogana
Transparenca dhe digjitalizimi	Përqindja e deklaratave doganore të përpunuara elektronikisht	100 %	100% deri në 2030	Dogana
Forcimi i luftës kundër mashtrimit	Numri i rasteve të zbuluara përmes sistemit të riskut	199 raste	Rritje me 50% deri në 2029	Dogana/Ministria e Financave
Aftësimi i stafit	Përqindja e stafit të trajnuar për modulet e BE-së	N/A	100% deri në 2030	Dogana/AKSHI
Kënaqësia e komunitetit të biznesit	Përqindja e operatorëve ekonomikë që deklarojnë përmirësim të shërbimit	56 %	≥ 80% deri në 2030	Dogana/Ministria e Financave
Efikasiteti i burimeve financiare	Përqindja e projekteve të zbatuara brenda buxhetit dhe afateve	N/A	≥ 85% deri në 2029	Dogana/Ministria e Financave

5.3 Procedurat e raportimit, monitorimit dhe vlerësimit të progresit

Monitorimi i kësaj strategjie do të bazohet në zhvillimin e raporteve të rregullta mbi aktivitetet e planifikuara, duke krahasuar progresin real me objektivat dhe treguesit e vendosur në planin e veprimit. Raportet do të përfshijnë të dhëna mbi shkallën e arritjes së veprimeve të planifikuara, burimet e përdorura dhe produktet e përftuara. Në këtë mënyrë, procesi i monitorimit do të mundësojë jo vetëm vlerësimin e ecurisë së reformës, por edhe identifikimin e hershëm të pengesave dhe nevojës për ndërhyrje korrigjuese.

Koordinimi i plotë i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit është përgjegjësi e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e cila do të mbledhë dhe përpunojë informacionin e paraqitur nga strukturat e saj, autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie. Në rastet kur një veprim zbatohet nga më shumë se një institucion, përgjegjësia për koordinimin dhe përmbledhjen e informacionit i takon autoritetit të parë të përcaktuar në planin e veprimit. Raportet e progresit do të përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore mbi arritjen e objektivave dhe treguesve të performancës.

Raportimi mbi zbatimin e strategjisë do të kryhet në tri faza kryesore:

- **Raporti vjetor i progresit**, përgatitet brenda muajit mars të çdo viti nga Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, mbi bazën e informacionit të paraqitur nga autoritetet

zbatuese. Ky raport i paraqitet ministrit të Financave brenda datës 15 prill të çdo viti;

- **Raporti i vlerësimit të ndërmjetëm**, përgatitet brenda muajit korrik 2028 nga Drejtorja e Përgjithshme e Doganave. Ky raport do të analizojë përputhshmërinë e aktiviteteve të realizuara me planifikimin dhe do të mund të shërbejë si bazë për ndryshimin e planit të veprimit nëse konstatohet devijim. Ky raport i paraqitet ministrit të Financave brenda datës 15 gusht 2028;

- **Raporti përfundimtar i vlerësimit**, përgatitet brenda muajit tetor 2030 nga Drejtorja e Përgjithshme e Doganave. Ky raport do të japë një panoramë të plotë mbi efektivitetin, efikasitetin, rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e strategjisë, duke pasqyruar nivelin e përgatitjes së Shqipërisë për integrim në sistemin doganor të BE-së. Ky raport i paraqitet ministrit të Financave brenda datës 15 nëntor 2030.

Nëse raporti i vlerësimit të ndërmjetëm vërteton devijime nga aktivitetet e planifikuara (veprimet, treguesit e rezultateve dhe monitorimi), raporti i vlerësimit të ndërmjetëm mund të përbëjë bazën për fillimin e procesit të ndryshimit të planit të veprimit në lidhje me zbatimin e kësaj strategjie.

Vlerësimi përfundimtar, që do të kryhet në nëntor 2030, do të pasqyrojë performancën e të gjithë strategjisë. Ai do të raportojë mbi efektivitetin dhe efikasitetin e ndërhyrjeve dhe masën në të cilën janë arritur rezultatet e pritura. Vlerësimi do të përqendrohet në:



1. rëndësinë: shkallën në të cilën objektivat e përcaktuar iu përgjigjën nevojave dhe prioriteteve kombëtare;

2. efektivitetin: shkallën në të cilën u arritën objektivat, nëse ndërhyrjet dhe mjetet e përdorura arritën rezultatet e pritura dhe nëse, duke përdorur mjete të ndryshme, mund të ishte arritur më shumë;

3. efikasitetin: nëse objektivat u arritën me koston më të ulët të mundshme;

4. qëndrueshmërinë: shkallën në të cilën rezultatet, duke përfshirë ndryshimet institucionale, janë të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Raportet e progresit, të vlerësimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Administratës Doganore.

KAPITULLI VI FINANCIMI I STRATEGJISË¹

Strategjia do të financohet përmes një kombinimi të burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përfshijnë alokime nga buxheti i shtetit, fonde të synuara të BE-së, si IPA III dhe IPA 2027 dhe mbështetje financiare ndërkombëtare të mobilizuara përmes projekteve me Bankën Botërore.

Strategjia synon ndërtimin e 23 sistemeve IT doganore, nga të cilat:

- 20 sisteme do të financohen nga buxheti i shtetit, për periudhën 2025–2030, dhe në tre faza, si në tabelën e mëposhtme.

në lekë

Fazat	Kostimi nga buxheti i shtetit
Faza I (2025–2027): Themelimi dhe përmirësimi i Sistemit të Automatizimit të Eksportit	198,000,000
Faza II (2027–2028): Modernizimi i Sistemit Kombëtar të Importit dhe menaxhimi i garancive	198,000,000
Faza III (2028–2030): Ndërfaqe me sistemet qendrore transevropiane të zhvilluara nga Komisioni, të cilat kërkojnë zhvillimin e komponentëve kombëtarë	165,000,000
Totali	561,000,000

- 3 sisteme janë të financuara nga donatorët.

Tre sistemet që do financohen nga donatorët janë: NCTS, Sistemi i Shkëmbimit të Certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së (EU CSW - CERTEX) dhe TARIC (*Tarif Integre Communautaire*).

Në lidhje me vlerën financiare për komponentët NCTS dhe NSW, pjesë e projektit Western Balkan TTFP 1, financiar nga Banka Botërore, vlerat janë si më poshtë.

- NCTS *system implementation*, faza 5 – vlera e kontratës = 1.938.000 euro;

- NCTS *System*, faza 6, grant i miratuar nga Banka Botërore për ACA = 450 mijë euro;

- NSW *System implementation*, vlera e parashikuar në planin e prokurimeve sipas Bankës Botërore, rreth 3.6 mln. euro. (ky komponent është akoma në fazë vlerësimin nga KVO-ja).

Në lidhje me vlerën financiare të ITMS-së (e cila përbëhet nga disa komponentë), për komponentin TARIC (*Tarif Integre Communautaire*) vlerat janë si më poshtë:

- Për kontratën 1.609.000 euro është paguar, buxheti total EUR 1.859.000.

- Shuma prej 250 000 euro nuk është paguar pasi do të financohet nga vetë fondet e BE-së (ashtu sikurse dhe buxheti total) në një fazë tjetër, kur të bëhet i mundur zbatimi i ITMS-së.

Përmirësimi i infrastrukturës *hardware* për sistemet doganore dhe rrjetet fizike, mbështetet nga projekti 24AG401, i financiar me fonde buxhetore në vlerën 465,000,000 lekë.

Ky kuadër i larmishëm financimi siguron që strategjia të mbetet elastike, e qëndrueshme dhe e pajisur me burime të mjaftueshme në të gjitha fazat e zbatimit.

Mekanizma të kontrollit financiar dhe transparencës

Do të krijohen mekanizma të fortë efikas të auditit të brendshëm dhe të jashtëm për të garantuar llogaridhënien financiare, transparencën dhe efikasitetin. Strategjia do të miratojë masat e mëposhtme:

¹ Sipas llogaritjeve të bëra nga UNCTAD.



- Auditime të pavarura të kryera periodikisht, në përputhje me legjislacionin shqiptar për pjesën e financimeve buxhetore dhe standardet e BE-së për fondet e BE-së;

- Gjurmime digjital i shpenzimeve në të gjitha fazat, duke siguruar monitorim transparent të disbursimeve;

- Procedurat e prokurimit dhe kontraktimit në përputhje me rregullat e UNCTAD (OKB-së), legjislacionin e BE-së dhe legjislacionin kombëtar;

- Mekanizma raportimi tremujor për Ministrinë e Financave dhe partnerët ndërkombëtarë për të siguruar pajtueshmërinë dhe mbikëqyrjen.

Këta mekanizma do të ofrojnë transparencë dhe besueshmëri, duke përforcuar, gjithashtu, besimin e donatorëve.

Përcaktimi dhe ndarja e kostove

Përmirësimi i sistemit ASYCUDA, në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit Evropian (UCC) me fondet e buxhetit të shtetit

Kostot e strategjisë do të përcaktohen dhe ndahen sipas tri fazave të zbatimit. Për periudhën 2025–2027, financimi do të drejtohet drejt zhvillimit fillestar dhe modernizimit të sistemeve kryesore kombëtare, ndërsa për periudhën 2028–2030, burimet do të përparësojnë integrimin me platformat në nivel BE-je, si dhe mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjeve të zbatuara.

Korniza financiare është e organizuar si më poshtë:

Faza I (2025–2027): Themelimi dhe përmirësimi i Sistemit të Automatizimit të Eksportit

- Financimi i vlerësuar: 198 milionë lekë, afërsisht 35% e kostove totale të strategjisë me fonde buxhetore sipas planit të veprimit.

Rezultatet:

- **Rezultati 1: Përmirësimi i Sistemit të Automatizuar të Eksportit (AES) ASYCUDA**

Kjo fazë e parë përqendrohet në përmirësimin e Sistemit aktual të Automatizuar të Eksportit (AES) ASYCUDA të Shqipërisë në platformën e gjeneratës së re ASYCUDA, në përputhje të plotë me Kodin Doganor të Unionit (UCC) dhe legjislacionin e tij kombëtar doganor që rregullon eksportin dhe daljen e mallrave.

- **Rezultati 2. Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar të Hyrjes (NES).** Integrimi i funksionaliteteve për njoftimin e mbërritjes, njoftimin e prezantimit dhe magazinimin e përkohshëm AN/PN/TS

Ky produkt mbulon zhvillimin dhe **vendosjen e Sistemit Kombëtar të Hyrjes (NES)** që mbulon njoftimin e mbërritjes (AN), njoftimin e prezantimit (PN) dhe magazinimin e përkohshëm (TS).

Faza II (2027–2028): Modernizimi i Sistemit Kombëtar të Importit dhe Menaxhimi i Garancive

- Prioriteti i financimit i vlerësuar: 198 milionë lekë, afërsisht 35% e kostove totale të strategjisë.

Rezultatet:

- **Rezultati 3. Përmirësimi i Sistemit Kombëtar të Importit (NIS) ASYCUDA**

Ky projekt synon të përmirësojë Sistemin Kombëtar të Importit (NIS) ASYCUDA të Shqipërisë për të siguruar përputhshmëri të plotë me Kodin Doganor të Bashkimit (UCC) dhe përafrimin me legjislacionin kombëtar doganor që rregullon importin e mallrave.

Sistemi i përmirësuar do të integrojë të gjitha proceset dhe kërkesat përkatëse të të dhënave që rrjedhin si nga UCC-ja ashtu edhe nga kornizat ligjore vendase. Kjo do t'i mundësojë NIS-it të mbështesë të gjitha detyrimet ligjore dhe procedurale sipas rregulloreve kombëtare doganore të UCC-së dhe atyre kombëtare.

- **Rezultati 4. Menaxhimi i Garancive ACA (GUM2)**

Ky rezultat përqendrohet në zhvillimin dhe vendosjen e modulit kombëtar për sistemin e Menaxhimit të Garancive ACA, i referuar si GUM2. Si një element thelbësor i fazës II, ky komponent është thelbësor për të mundësuar administrimin, monitorimin dhe zbatimin efektiv të garancive në nivel kombëtar.

Faza III (2028–2030): Ndërfaqe me sistemet qendrore transevropiane të zhvilluara nga Komisioni të cilat kërkojnë zhvillimin e komponentëve kombëtarë

Prioriteti i financimit i vlerësuar: 165 milionë lekë, 30% e kostove totale të strategjisë.

Rezultatet:

- Zhvillimi i ndërfaqeve, komponentëve dhe bazave të të dhënave kombëtare për integrimin me 17 sisteme në nivel BE-je (CCI, TARIC, ICS2, CRMS2, EORI2, TQS, UUM&DS, SURV3, AEO, COPIS, ICG, CDS, REX, INF, PoUS, SMS, ECICS)

- Krijimi i një kuadri mirëmbajtjeje dhe mbështetjeje për të gjitha sistemet e zbatuara.

Kjo strategji paraqet zhvillimin e 23 sistemeve IT dhe të kostuara, sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela: Sistemet e IT dhe kostimi i tyre

Nr.	Sistemet		Kostoja totale e sistemeve	
	Emri i sistemit të BE-së	Buxheti i shtetit	Donatorë	Totali
	Sisteme të centralizuara			
1.	NCTS	0	2 388 000 EUR	2 388 000 EUR
2.	Sistemi i Automatizuar i Eksportit (AES)	Faza I <i>up grade</i> (shiko total) 2.4 milionë USD		
3.	Zhdoganimi i centralizuar i UCC-së për Import (CCI)	Përfshihet te faza III	0	
	Sisteme qendrore transevropiane			
1.	Sistemi i Shkëmbimit të Certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së (EU CSW -CERTEX)		3.6 milionë EUR	3.6 milionë EUR
2.	Sistemi i Importit të Mallrave Kulturore (sistemi ICG)	Faza III (shiko total)		
3.	Sistemi i Kontrollit të Importit UCC 2 (ICS2)	Faza III <i>up grade</i> (shiko total) 2 milionë USD (total)		
4.	Sistemi i Menaxhimit të Riskut Doganor (CRMS2)	Faza III (shiko total)		
5.	Sistemi i Vendimeve Doganore të UCC-së (CDS))	Faza III (shiko total)		
6.	Sistemi i Menaxhimit Uniform të Përdoruesve dhe Nënshkrimit Digjital (UUM&DS)	Faza III (shiko total)		
7.	Sistemi UCC i eksportuesit të regjistruar (REX)	Faza III (shiko total)		
8.	Informacioni Tarifor i Detyrueshëm Evropian (EBTI)	Shiko ITMS		
9.	Mbikëqyrja 3	Faza III (shiko total)		
10.	Informacion për UCC-në			
11.	Operatorët Ekonomikë të Autorizuar të UCC-së – AEO	Faza III (shiko total)		
12.	Menaxhimi i Garancive UCC (GUM)	Faza II (shiko total)		
13.	Prova e Statusit Union të UCC-së (PoUS)	Faza III (shiko total)		
14.	COPIS	Faza III (shiko total)		
15.	TARIC (<i>Tarif Integre Communautaire</i>)		250.000 EUR	250.000 EUR
16.	TQS (Kuotat Tarifore dhe Mbikëqyrja)	Shiko ITMS		
17.	Sistemi i Regjistrimit dhe Identifikimit të Operatorëve Ekonomikë UCC 2 – EORI2	Faza III(shiko total)		
18.	Moduli SMS (Sistemi i Menaxhimit të Mostrave)	Shiko ITMS		
	Kërkesat e BE-së për NC			
1.	Njoftimi i Mbëritjes UCC, Njoftimi i Prezantimit dhe Magazinimi i Përkohshëm AN/PN/TS	Faza I (shiko total)		
2.	Sistemi Kombëtar i Importit (NIS) i UCC-së	Faza II <i>up grade</i> (shiko total)		
	Totali			

KAPITULLI VII BASHKËPUNIMI RAJONAL

7.1 Rëndësia strategjike e bashkëpunimit rajonal

Shqipëria ndodhet në një pozicion gjeografik strategjik në Ballkanin Perëndimor, duke u bërë një lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit, mes Evropës Juglindore dhe Mesdheut. Kjo pozitë e veçantë e vendit, përveçse përfitim ekonomik, sjell edhe një sërë sfidash të lidhura me kontrollin doganor, sigurinë kufitare dhe menaxhimin e flukseve tregtare.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi rajonal nuk është një opsion, por një domosdoshmëri. Ai përfaqëson një mekanizëm për të ulur kostot tregtare, për të reduktuar kohën e transportit dhe për të parandaluar kontrabandën dhe krimin e organizuar. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi me vendet e rajonit është një provë konkrete e aftësisë së Shqipërisë për të vepruar si pjesë e një tregu të integruar evropian.

7.2 Kuadri politik dhe institucional i bashkëpunimit rajonal

Shqipëria është pjesë e disa nismave rajonale e ndërkombëtare, të cilat përbëjnë bazën institucionale të bashkëpunimit në fushën doganore:

- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA): krijon një zonë tregtare pa tarifa ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të saj, Shqipëria ka detyrimin të lehtësojë tregtinë, të reduktojë barrierat jotarifore dhe të zbatojë praktika të standardizuara doganore.

- Procesi i Berlinit: nxit zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, i cili përfshin njohjen reciproke të certifikatave, digjitalizimin e procedurave doganore dhe krijimin e një hapësire tregtare rajonale në përputhje me BE-në.

- Nismat bilaterale: përfshijnë marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Italinë, me fokus në shkëmbimin e informacionit doganor dhe parandalimin e kontrabandës.



- Nismat e BE-së dhe organizatave ndërkombëtare: përmes fondeve IPA dhe asistencës nga DG TAXUD dhe Organizata Botërore e Doganave (WCO), Shqipëria merr mbështetje për harmonizim rajonal.

7.3 Prioritetet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

a) Harmonizimi i procedurave dhe standardeve

Një nga pengesat më të mëdha në tregtinë rajonale është mosuniformiteti i procedurave doganore. Shqipëria ka si prioritet:

- standardizimin e dokumenteve doganore në përputhje me CEFTA dhe BE;
- njohjen reciproke të certifikatave të origjinës;
- implementimin e procedurave të përbashkëta të riskut.

Ky hap do të ulë ndjeshëm kohën dhe kostot për bizneset, duke përmirësuar ndjeshëm klimën tregtare në rajon.

b) Shkëmbimi elektronik i informacionit

Një sistem modern doganor nuk mund të funksionojë pa shkëmbim të menjëhershëm informacioni me vendet fqinje. Shqipëria synon të ndërtojë mekanizma të përbashkët IT-je me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, duke ndarë:

- të dhëna mbi deklaratat doganore;
- informacion mbi operatorët ekonomikë;
- sinjale të hershme mbi mallrat me risk të lartë.

Ky shkëmbim do të reduktojë kontrabandën, mashtrimet fiskale dhe do të rrisë sigurinë e kufijve.

c) Krijimi i korridoreve të gjelbra

Shqipëria, së bashku me partnerët e saj rajonale, do të zhvillojë korridore të gjelbra për mallrat strategjike dhe për operatorët ekonomikë të certifikuar AEO. Nëpërmjet këtyre korridoreve, mallrat nuk do të ndalohen në çdo pikë kufitare, por do të kalojnë përmes një procesi të përshpejtuar. Ky mekanizëm do të shkurtojë ndjeshëm kohën e transportit dhe do të ulë shpenzimet logjistike.

7.4 Shembuj konkretë të bashkëpunimit rajonal

Shqipëri–Kosovë

Shqipëria dhe Kosova kanë ngritur tashmë modele bashkëpunimi të avancuar, si pikat e përbashkëta doganore, ku kontrollet kryhen njëherësh për të dyja shtetet. Ky sistem ka ulur ndjeshëm kohën e kalimit të mallrave dhe ka rritur besueshmërinë e tregut të përbashkët Shqipëri–Kosovë.

Shqipëri–Maqedoni e Veriut

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut si vende fqinje dhe anëtare të CEFTA-s, kanë zhvilluar ndër vite një bashkëpunim të ngushtë doganor, të mbështetur nga marrëveshje bilaterale dhe rajonale, si dhe nga programet e BE-së dhe të Organizatës Botërore të Doganave (WCO), SELEC. Ky bashkëpunim synon lehtësimin e tregtisë, forcimin e sigurisë kufitare dhe luftën kundër kontrabandës. Në pikën “Qafë Thanë–Kjafasan” është zbatuar modeli i kalimit të koordinuar, ku palët shkëmbejnë të dhëna paraprakisht për mjetet dhe mallrat. Palët kanë marrëveshje për “shkëmbim të dhënash elektronike”, SEED.

Shqipëri–Mali i Zi

Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale për “Bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë doganore”.

Funksionon koncepti i kontrollit të përbashkët doganor dhe kufitar në pikën kufitare Hani i Hotit – Bozhaj, si dhe Muriqan–Sukobin. Kjo nënkupton që udhëtarët dhe mallrat kontrollohen vetëm një herë nga autoritetet doganore dhe policore të të dyja vendeve, duke lehtësuar fluksin e lëvizjes. Palët kanë marrëveshje për “shkëmbim të dhënash elektronike”, SEED.

Gjithashtu, Shqipëria dhe Mali i Zi janë pjesë e marrëveshjes CEFTA, ku në kuadër të saj është punuar për ngritjen e “korridoreve të gjelbra” gjatë pandemisë COVID-19 për lëvizjen e mallrave esenciale dhe po punohet për përmirësimin e zgjerimin e infrastrukturës së tyre.

Gjithashtu, administratat doganore kanë përfutur trajnime dhe ngritje kapacitetesh mbi tematikat e menaxhimit të riskut, skanimit, kontrollit të drogës dhe armëve me përqsje rajonale dhe më gjerë nëpërmjet CEFTA-s, OBD-së, SELEC-it etj.

Shqipëri–Greqi–Itali

Si dy nga partnerët më të mëdhenj tregtarë të Shqipërisë, Greqia dhe Italia kanë një rëndësi të veçantë në bashkëpunimin doganor. Ky bashkëpunim përfshin:

- koordinimin në kontrollet e mallrave bujqësore dhe ushqimore;
- shkëmbimin e informacionit për kontrabandën nëpërmjet kufijve detarë;
- përgatitjen për integrimin e sistemeve shqiptare me rrjetin doganor të BE-së.



7.5 Sfida të bashkëpunimit rajonal

Megjithëse janë bërë hapa përpara, ekzistojnë sfida të dukshme:

- mungesa e besimit të plotë mes disa vendeve të rajonit;
- ndryshimet në kapacitetet teknologjike mes vendeve;
- burokracitë e brendshme që ngadalësojnë procesin e harmonizimit;
- mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare për të implementuar sistemet e përbashkëta.

Për të kapërcyer këto sfida, Shqipëria duhet të forcojë rolin e saj si promotor i bashkëpunimit rajonal dhe të kërkojë mbështetje të vazhdueshme nga Bashkimi Evropian.

7.6 Roli i BE-së dhe organizatave ndërkombëtare

Komisioni Evropian mbetet partneri kryesor për mbështetjen e bashkëpunimit rajonal në fushën doganore. Përmes fondeve IPA dhe asistencës teknike nga DG TAXUD, BE-ja ndihmon vendet e rajonit të zhvillojnë sisteme të përbashkëta dhe të implementojnë standardet evropiane. Po ashtu, Organizata Botërore e Doganave (WCO) ofron kornizën e vet të standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e riskut dhe lehtësimin e tregtisë.

7.7 Përfitimet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

Forcimi i bashkëpunimit rajonal i sjell Shqipërisë përfitime të drejtpërdrejta:

- Rritje e efikasitetit tregtar: reduktim i kohës së kalimit në kufi dhe ulje e kostove për bizneset;
- Siguri më e madhe: falë shkëmbimit të informacionit mbi kontrabandën dhe krimin e organizuar;
- Përshejtim i integritetit në BE: pasi BE-ja vlerëson aftësinë e vendeve të Ballkanit për të bashkëpunuar përpara anëtarësimit.

7.8 Përfundim mbi bashkëpunimin rajonal

Bashkëpunimi rajonal është një faktor i pazëvendësueshëm i reformës doganore. Vetëm përmes tij Shqipëria do të arrijë të ketë sisteme që jo vetëm janë të përputhshme me BE-në, por që funksionojnë në mënyrë të integruar me vendet e rajonit. Ky bashkëpunim do të lehtësojë tregtinë, do të rrisë sigurinë dhe do të përshpejtojë procesin e integritetit evropian, duke e bërë Shqipërinë një aktor kyç në arkitekturën e re doganore të Ballkanit Perëndimor.

KAPITULLI VIII PËRFUNDIME

8.1 Mbyllja e ciklit të reformës dhe rëndësia historike

Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor 2025–2030 është një ndërmarrje strategjike me rëndësi të veçantë për shtetin shqiptar. Ai përfaqëson një kthesë historike në zhvillimin institucional të vendit, pasi për herë të parë Shqipëria synon të ndërtojë një administratë doganore që nuk është vetëm e krahaseshme, por edhe plotësisht e përputhshme me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Kjo strategji nuk duhet parë si një detyrim teknik apo një ushtrim burokratik për procesin e integritetit, por si një **strategji transformuese** që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë kombëtare, në funksionimin e shtetit ligjor dhe në perspektivën e integritetit politik të Shqipërisë. Përfundimi i tij i suksesshëm do të shënojë jo vetëm arritjen e standardeve të BE-së, por edhe forcimin e pozicionit të Shqipërisë si një faktor stabiliteti dhe zhvillimi në Ballkanin Perëndimor.

8.2 Përfitimet institucionale dhe administrative

Reforma doganore e parashikuar në këtë strategji pritet të sjellë një modernizim rrënjësor të administratës publike në disa dimensione:

- Forcimi i kapaciteteve institucionale: administrata doganore do të pajiset me sisteme moderne, duke i dhënë asaj aftësi për të përpunuar dhe menaxhuar të dhëna, në përputhje me standardet evropiane;
- Depolitizim dhe profesionalizim: përmes mekanizmeve të rinj të trajnimit dhe certifikimit, stafi doganor do të kthehet në një trupë profesionale, të bazuar në meritokraci;
- Transparencë dhe integritet: digjitalizimi i procedurave do të reduktojë ndjeshëm kontaktin fizik mes qytetarëve, bizneseve dhe administratës, duke ulur mundësitë për korrupsion dhe duke rritur llogaridhënien;
- Forcimi i kapacitetit kontrollues: përdorimi i sistemeve të avancuara të riskut (CRMS, ICS2) do të bëjë të mundur identifikimin e hershëm të rreziqeve, duke e bërë administratën shqiptare më të aftë për të luftuar kontrabandën dhe krimin e organizuar.



8.3 Përfitimet ekonomike dhe tregtare

Nga një perspektivë ekonomike, kjo strategji është një investim strategjik që do të gjenerojë përfitimë afatgjata:

- Reduktim i kohës së zhdoganimit: bizneset shqiptare do të kursejnë kohë dhe vlerë monetare, duke përmirësuar ndjeshëm konkurrueshmërinë e tyre;

- Integrim në tregun evropian: eksportuesit shqiptarë do të kenë akses më të shpejtë dhe më të sigurt në tregun e përbashkët, falë përputhshmërisë me sistemet e BE-së;

- Thithje e investimeve të huaja: një administratë doganore transparente dhe e besueshme do të krijojë një klimë më të favorshme për investitorët ndërkombëtarë;

- Formalizim i ekonomisë: ulja e kontrabandës dhe e evazionit fiskal do të rrisë të ardhurat në buxhet dhe do të nxisë formalizimin e tregut të brendshëm.

8.4 Përfitimet sociale dhe politike

Kjo strategji ka, gjithashtu, dimensione të rëndësishme sociale dhe politike:

- Rritje e besimit tek institucionet: qytetarët dhe bizneset do të perceptojnë administratën si më transparente dhe më shërbyese;

- Përforsim i shtetit ligjor: zbatimi i rregullave dhe standardeve të BE-së në dogana është një hap i drejtpërdrejtë drejt forcimit të sundimit të ligjit;

- Stabilitet politik: përparimi në këtë fushë do të përshpejtojë procesin e integritit, duke konsoliduar mbështetjen e publikut për reformat evropiane.

8.5 Ndikimi në procesin e integritit evropian

Modernizimi i doganave shqiptare përfaqëson një ndër testet më të rëndësishme të procesit të integritit në BE. Në mënyrë specifike:

- Kapitulli 29 (Bashkimi Doganor): do të mbyllet vetëm nëse Shqipëria arrin përputhje të plotë me *Union Customs Code* dhe implementon sistemet përkatëse.

Në këtë mënyrë, kjo strategji nuk është një dokument i izoluar, por një element kyç i negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

8.6 Sfidat e ardhshme dhe qëndrueshmëria

Edhe pse strategjia është ambicioze, duhet thënë se Shqipëria do të përballet me sfida të vazhdueshme:

- Mirëmbajtja financiare: pas vitit 2030, sistemet e reja do të kenë nevojë për fonde të rregullta për mirëmbajtje dhe përditësim;

- Siguria kibernetike: duke qenë se doganat do të jenë tërësisht digjitale, sulmet kibernetike mbeten një kërcënim real;

- Kapacitetet njerëzore: stafi doganor duhet të trajnohet vazhdimisht për të ndjekur zhvillimet teknologjike;

- Bashkëpunimi rajonal: sukses i plotë nuk mund të arrihet nëse reformat shqiptare nuk ecin paralelisht me ato të vendeve të rajonit.

8.7 Vizioni afatgjatë për Shqipërinë në sistemin doganor evropian

Vizioni i kësaj strategjie është që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një administratë doganore moderne, efikase dhe plotësisht të integruar me BE-në. Kjo administratë do të ketë këto karakteristika:

- Teknologji të avancuara: sisteme të unifikuara dhe të ndërveprueshme me rrjetin doganor evropian;

- Integritet dhe llogaridhënie: një administratë që funksionon mbi parime etike dhe transparente;

- Qasje partneriteti me biznesin: doganat nuk do të perceptohen më si pengesë, por si partner në zhvillim;

- Siguri e lartë kufitare: kufij të mbrojtur, me analiza të sofistikuaru risku dhe bashkëpunim ndërkombëtar;

Në këtë mënyrë, Shqipëria nuk do të jetë më vetëm një vend kandidat, por një aktor funksional i hapësirës doganore evropiane, i gatshëm për të kontribuar në stabilitetin dhe zhvillimin e rajonit.

Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor 2025–2030 është një kontratë kombëtare mes qeverisë, biznesit dhe qytetarëve, por njëkohësisht edhe një kontratë ndërkombëtare me Bashkimin Evropian. Ai përfaqëson jo vetëm një plan reformash, por një premim politik dhe ekonomik që Shqipëria i bën vetes dhe partnerëve të saj ndërkombëtarë.

Nëse zbatohet me përpikëri, transparencë dhe qëndrueshmëri, kjo strategji do të shënojë një moment kthese historike për Shqipërinë, duke e vendosur vendin në një trajektore të pakthyeshme drejt integritit evropian dhe duke e shndërruar atë në një shtet modern, të besueshëm dhe konkurrues në arenën ndërkombëtare.



Shtojca 1

Plani i Veprimit të Strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor shqiptar në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030

Sistemet e Decentralizuara

Emri i Sistemit të BE-së	Sisteme të decentralizuara trans-evropiane të zhvilluara nga Komisioni dhe që kanë një komponent kryesor kombëtar që do të zhvillohen dhe zbatohen nga vendet kandidatë.	Prioritet	Gjendja aktuale	Përkrahësi i sistemit TT të AI, CUSTOMS	Plani i aktiviteteve të doganave shqiptare	Zhvillimi/testimi dhe vlerat në përdorim e sistemit IT	Sektorët përzgjedhur të Doganave	Shuma	Financuesi	
1. NCTS	Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transizit (NCTS) është një sistem digital në të gjithë Evropën, i projektuar për të ofruar menaxhimin dhe kontrollin më të mirë të mallrave sipas Transizit të Bashkimit dhe Transizit të Përbashkët. Ai përfshin të gjitha vendet e BE-së dhe politikat kontraktuese të Konventës së Transizit të Përbashkët (CTC). Bazarar në deklarim të transizit, NCTS përpunon të dhëna e sigurisë për formalitetet e hyrjes dhe daljes. Sipas Planit Kombëtar të Projektit të Shqipërisë (NPP), data e propozuar 01.07.2026 për fillimin e NCTS P5 në nivel kombëtar. Bazarar në rregullin që NCTS mund të përdoret vetëm në nivel të përbashkët pas të paktën një viti funksionimi në nivel kombëtar. Fillimi i NCTS P5 në përbashkëti është planifikuar për 01.07.2027. Data e propozuar 01.07.2026 për fillimin e operacioneve NCTS P5 në nivel kombëtar bazohet në prishësitë që të gjitha dispozitat e nevojshme ligjore, administrative dhe procedurale në përputhje me CTC do të jenë në fuqi deri në tremujorin e parë të vitit 2026. Do të kërkohej gjithashtu disa muaj për trajnimin e ofruesve doganorë dhe operatorëve ekonomikë. Kërkesa që Shqipëria të sigurojë kllidjen CCNCSI gjatë Zbatimit të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transizit (NCTS) për të filluar Testimin e Konformimit të doganave TAXUD së në 18.08.2025. Megjithatë, këto aktivitete mund të ndryshojnë në varësi të vendimit të TAXUD-së që Shqipëria të fillojë testimin e Konformimit.	I lartë	Kompania përzgjedhëse për zbatimin e sistemit ka instaluar ERMS (NCTS) P5 në mjedisin e testimit, ka përfunduar konfigurimin e infrastrukturës, ka zhvilluar objektet e nevojshme, ka krijuar liguri përkrahëse dhe ka prezantuar DEMO-në në ambientet e doganës. Aktualisht, ata janë në proces të integritetit të shërbimit AKSHH Remote Sign-in për nëshkrimin elektronik, si dhe integrimin e hyrjes Entra ID Azure për përdoruesin e Doganës dhe Single Sign-On nëpërmjet e-Albania për operatorët ekonomikë.	Applikacioni aktual në mjedisin e testimit që funksionon është DDNTA 5.15.2	Lidhur me temat e referencës/specifikimet teknike për përmirësimin e fazës 6 në opsionin OPT-Out, janë përgatitur nga PIU të miratuara nga Banka Botërore. Ministria e Financave do të fillojë negociatat me kompaninë për fazën përfundimtare.	Sistemi ERMS (NCTS) P5 është instaluar në mjedisin e testimit dhe përdoret për krijimin. Sipas Planit Kombëtar të Projektit (NPP), fillimi i NCTS P6 të përbashkët është parashikuar për 01.07.2027. Megjithatë, ky afat kohor varet ngushtsisht nga zbatimin e kllidjes CCNCSI. Plani do të duhet të rishikohet pas nëshkrimit të kontratës për kalimin në Fazën 6 të NCTS, në mënyrë që Shqipëria të jetë gati për t'u bashkuar me NCTS të përbashkët me Fazën 6.	Sektorët i Lehtësuarve, Drejtoria e Procedurave, Sektori i Lagës, grupi i punës i ngritur, AKSHH	NCTS system implementation, faza 5 - vlera e Kontratës = 1,938,000 mbi Euro. NCTS System, faza 6. Grant i miratuar nga Banka Botërore për ACA = 450 mbi Euro.	Banka Botërore	
2. Sistemi i Automatizimit të Eksportit (AES)	Sistemi i Automatizimit të Eksportit (AES) është një sistem mbartë-evropian që mbështet eksportin dhe daljen e qetë të mallrave nga Teritori Doganor i Bashkimit. Është një evolucion i Sistemit të mëparshëm të Eksportit (ECS-P2). AES përdoret nga administratat doganore të Shteteve Anëtare dhe HMRC e Mbretërisë së Bashkuar për zbatimin e Protokollit të Irlandës së Veriut. Ai lëviz digitalizimin dhe modernizimin e formaliteteve të eksportit dhe daljes së kërkuar nga UCC. AES përbëhet nga dy komponentë: 1) 'AES Trans-Evropian' që zbaton në një mënyrë të harmonizuar proceset dhe shkëmbimet e informacionit midis autoriteteve doganore në Shtete të ndryshme Anëtare (për shërbimet në koston dhe eksporit indirekt) dhe 2) 'Sistemi Kombëtar i Eksportit' që mbulon proceset dhe shkëmbimet e informacionit që zhvillohen në nivel kombëtar (duke mos përfshirë Shtete të tjera Anëtare). 'AES Trans-Evropian' duhet të zbatohet të gjitha proceset dhe formalitetet e procedurave doganore të lidhura me eksportin, siç parashikohen nga UCC dhe kërkesat e të dhënave të përcaktuara në versionin më të fundit të Shteteve B të Akteve të Deleqara dhe Zbatuesit të UCC. Ky sistem duhet të mbështet manualisht e ndryshme për paraqitjen e një deklarate doganore (rieksporti) (deklarate standarde, deklarate të thjeshtuara/plotësues dhe deklarate të para-paraqitura). Sistemi duhet gjithashtu të jetë në gjendje t'i lejojë operatorët ekonomikë të përfundojë nga lehtësime të tjera të UCC-së, siç është zhdoganimi i centralizuar për eksport (që është pjesë e specifikimeve të sistemit AES të ofruara në mënyrë qendrore) dhe Hyra në të Dhëna të Deklaratës (që duhet të përcaktohen, zhvillohen dhe zbatohen në nivel kombëtar). Një ndërfaqe kombëtare e AES me EMCS dhe me NCTS-P5 duhet të zhvillohet për deklarim (rieksport) që përfshijë mullatë akcize nën marrëveshjet e pezallimit të detyrimeve dhe për situatë e eksportit të ndjekura nga tranziti, përkatësisht, 'Sistemi Kombëtar i Eksportit' duhet të zbatohet proceset e UCC-së për Deklaratën Përmblidhëse të Daljes (EXS) dhe Njoftimet e Ri-eksportit (REN). Për më tepër, komponenti 1 i Procedurave Speciale të UCC-së - 'SP Kombëtare EXP' - referuar në pikën 12 në Aneksin e Programit të Punës së UCC-së duhet të jetë pjesë e Sistemit Kombëtar të Eksportit. Duhet të jetë në gjendje të trajtojë deklarimet e rieksportit për të shikuar procedurat speciale dhe deklarimet doganore për procedurën e përpunimit pasiv) me kërkesat e të dhënave të Aneksit B. Përdorimi i sistemit AES u lejon autoriteteve doganore të certifikojnë daljen e mallrave për qëllime të TVSH-së (dhe taksave të tjera). Duke përmirësuar proceset doganore dhe duke ofruar më shumë lehtësi tregtare, AES përfundon konkurrencën e bizneseve evropiane. Shqipëria duhet të zhvillojë Sistemin e saj Kombëtar të Eksportit në përputhje me kërkesat e UCC-së, për të cilat kështohet të rëpërdoren "Specifikimet Teknike të AES" të ofruara nga Komisioni. Sistemi kombëtar duhet të ndërveprojë me komponentin të tjerë kombëtarë (si TARIC, moduli i Menaxhimit të Riskut).	I lartë	AES do të aplikohet gjatë fazës I të përmirësimit të sistemit ASYCUDA.	Sistemi ekzistues i eksportit do të përmirësohet nëpërmjet përmirësimit të Projektit ASYCUDA, i cili do të krijojë bashkë për dorëzimin e deklarimit të eksportit vetëm në formë elektronike, siç bashkohet me dorëzimin elektronik të dokumenteve shoqëruese. Megjithatë, procedura e eksportit nuk lejon njoftimin para mbërritjes së mallrave. Në projektin "Përmirësimi i sistemit ASYCUDA në krijimin e eksportit të automatizuar (AES) Faza I" thuhet se sistemi ekzistues i eksportit në Administratën Doganore do të përmirësohet me specifikimet më të fundit të DG TAXUD, në mënyrë që të jetë plotësisht në përputhje me sistemin e BE-së për Procedurën e Automatizuar të Eksportit.	Fillimi i zbatimit të projektit "Përmirësimi i sistemit ASYCUDA të Administratës Doganore të Shqipërisë" në krijimin e sistemeve të automatizuara të eksportit (AES) pritet në vitin 2027. Projekti do të zgjatë 18 muaj. Financimi do të sigurohet nga buxheti i shtetit gjatë Fazës I të Përmirësimit të sistemit ASYCUDA të Administratës Doganore të Shqipërisë.	Tremujori i 4-të i vitit 2025 - Tremujori i parë i vitit 2027. Rezultatet e para të preklushe brenda 12 muajve nga lançimi i Fazës I	Grupi i punës i ngritur, Sektori për Procedurat Doganore	2.4 million USD (Faza I e upgrade të sistemit ASYCUDA)	Buxheti Shtetit	
3. Zhdoganimi i Qendruar i UCC-së për Import (CCI)	Sistemi CCI siguron digitalizimin e procesit të zhdogimit të centralizuar në nivel evropian, siç përcaktohet në UCC. Ai u lejon tregtarëve të besuar të paraqesin një deklarim doganor në zyrat doganore mbledhëse në Shtetin Anëtar, duke mundësuar përpunimin e deklarimit doganorë të listimit fizik të mallrave në një mënyrë dixhitale, efektive, të parashikueshme dhe të koordinuar midis zyrave doganore të vendosura në Shtete të ndryshme Anëtare. Të gjitha kontaktet e tregtarëve zhvillohen në zyrat doganore mbledhëse, duke vënuar si një one-stop shop. Shqipëria duhet të zhvillojë të paktën komponentin kombëtar të sistemit sipas specifikimeve funksionale dhe teknike të CCI të ofruara nga Komisioni. Komponenti kombëtar i CCI duhet të ndërveprojë me komponentin të tjerë kombëtarë (si TARIC, moduli i Menaxhimit të Riskut, sistemet e kontrollimit dhe sistemet të tjera kombëtare dhe qendrore), siç përcaktohet në specifikimet e përshkruara funksionale dhe teknike të CCI. Para fillimit të operacioneve, Shqipëria do të duhet të certifikojë zbatimin e datur duke kryer aktivitetet testimit kundërt Mjetit të Testimit të Konformimit (CTA) të parashikuar nga Komisioni. Si parakusht, vendi duhet të sigurojë komunikimin me të gjitha administratat kombëtare të shteteve anëtare nëpërmjet rregullit CCN2, siç bashkohet me integrimin e sistemit qendror përkatës të ofruar nga Komisioni (duke përfshirë CS/MIS2; CS/RID; Mbledhësynë 3). Pasi Komisioni të certifikojë se komponenti kombëtar i zhdogimit rishikoi CCI është në përputhje me specifikimet e përshkruara të CCI, vendi kandidat do të vendosë sistemin e tij në mjedisin e Operacioneve nën udhëzimet e repra të Komisionit.		Administrata Doganore nuk ka një sistem për zhdogimin të centralizuar (ky do të aplikohet gjatë fazës III të përmirësimit të sistemit ASYCUDA).	Në projektin "Përmirësimi i sistemit ASYCUDA në krijimin e Zhdogimit të Centralizuar për Import (CCI) Faza III" thuhet se ai do të zbatohet me specifikimet më të fundit të DG TAXUD, në mënyrë që të jetë plotësisht në përputhje me sistemin e BE-së për Procedurën e Zhdogimit të Centralizuar për Import.	Në kuadër të projektit "Përmirësimi i Sistemit ASYCUDA të Administratës Doganore të Shqipërisë - Faza III", sistemi i Zhdogimit të Centralizuar për Import (CCI) i UCC pritet të zbatohet në tremujorin e katërt të vitit 2030. Financimi do të sigurohet nga buxheti i shtetit.	Tremujori i parë i vitit 2028 - Tremujori i katërt i vitit 2030	Rezultatet e para të preklushe brenda 12 muajve nga lançimi i Fazës III	Grupi i punës i ngritur, Sektori për Procedurat Doganore	Perfshihet tek Faza III e përmirësimit të sistemit ASYCUDA	Buxheti Shtetit



Kërkesat e BE-së për sistemet kombëtare

Emri i Sistemit të BE-së	Kërkesat e BE-së për sistemet kombëtare - që do të zhvillohen ekskluzivisht nga vendet kandidatë me qëllim zbatimin e proceseve siç përcaktohen në UCC dhe legjislacionin e BE-së për SW (Sportet i Vetëm).	Prioritet	Situata aktuale	Përshkrimi i sistemit ADSSH / Përpunshmëria me BE-në	Plani i aktiviteteve të ADSSH-së	Zhvillimi/testimi dhe vënja në përdorim e sistemit IT	Sektori i ADSSH-së/personi i kontaktit	Shuma	Financuesi
1. Njiftimi i Mbërritjes UCC, Njiftimi i Prezantimit dhe Magazinit të Përkohshëm ANPN/TS	Zhvillimi dhe përmirësimi i këtyre proceseve, siç kërkohet nga UCC, është nën përgjegjësinë kombëtare. Është detyrë e vendit kandidat të zbatojë proceset në një ose disa sisteme. Synon të zbatojë proceset e UCC për Njiftimin e Mbërritjes, Njiftimin e Prezantimit dhe Deklaratën e Magazinit të Përkohshëm dhe të harmonizojë proceset dhe shkëmbinin e të dhënave me kërkesat e të dhënave (versioni në fundit i Aneksit B të Akteve të Deleaguara dhe Zbatuesit të UCC) në nivel kombëtar. Njiftimi i mbërritjes lufhet me një mjet transporti (ose avion ose anije) dhe duhet të depozitohet në aeroportin ose portin e parë ku mjeti i transportit mbërrin në territorin doganor të Bashkimit Evropian. Funkcionaliteti i njiftimit të mbërritjes përfshihet brenda ICS2. Nëse Shqipëria vendos të përdorë Nderfaqen e Përbashkët të Tregtarit ICS2 të operuar zakonisht, nuk është i nevojshëm zhvillim kombëtar. Funkcionaliteti i prezantimit duhet të zbatohet në të njëjtin kohë me komponentin e Sistemit Kombëtar të Hyrjes (NES) të ICS2. Njiftimi i prezantimit dhe deklarata e magazinimit të përkohshëm duhet të zbatohet si pjesë e NES të përputhje me kërkesat e të dhënave të versionit në fundit të Aneksit B të Akteve të Deleaguara dhe Zbatuesit të UCC.	I lartë	Administrata Doganore nuk ka një sistem ANPN/TS. Ai do të aplikohet gjatë fazës I të përmirësimit të sistemit ASYCUDA.	Administrata Doganore Shqiptare duhet të zbatojë projektin e përmirësimit të sistemit ASYCUDA, duke përfshirë ri-zbatimin e këtij komponenti, në mënyrë që të përmbushë plotësisht kërkesat e BE-së.	Ky komponent është parashikuar të përgatitet nga UNCTAD në kontratën aktuale. Duke marrë parasysh që deklarata e importit dhe deklarata e eksportit do të jenë plotësisht në përputhje me standardet e BE-së të parashikuara nga UCC, ai do të ri-zbatohet në mjedisin e ri brenda zbatimit të AES. Financimi do të sigurohet nga buxheti i shtetit.	Tremujori i 4-të i vitit 2025 – Tremujori i parë i vitit 2027. Rezultatet e para të preklime brenda 12 muajve nga lançimi i Fazës I	Grupi i punës i ngritur, Sektori për Procedurat Doganore	Përfshihet tek Faza I e përmirësimit të sistemit ASYCUDA	Buxheti Shtetit
2. Sistemi Kombëtar i Importit (NIS) i UCC-së	Ky sistem duhet të zbatojë të gjitha proceset dhe formulartet e procedurave doganore të lidhura me importin, siç parashikohen nga UCC dhe kërkesat e të dhënave, të përcaktuara në versionin në fundit të Aneksit B të Akteve të Deleaguara dhe Zbatuesit të UCC) të cilat lidhen me importin e mallrave në Bashkim. Ky sistem duhet të mbështesë mundësitë e ndryshme për paraqitjen e një deklarate doganore (p.sh. standarde, e thjeshtuar (përfshirë atë të para-paraqitjes), deklarata e bërë përmes hyrjes në të dhënat e deklaruesit, deklarata plotësi) dhe funksionalitetet për përpunimin e tyre në NIS. Zhodganimi i centralizuar për import në nivel kombëtar, siç parashikohet nga UCC, është gjithashtu pjesë e NIS. Ky sistem duhet të zbatojë të gjitha proceset për procedurat speciale siç parashikohen nga UCC (domethënë, magazinimi doganor, përdorimi përfundimtar, pranimi i përkohshëm dhe përpunimi aktiv) me kërkesat e të dhënave të Aneksit B. Komponenti 2 i Procedurave Speciale të UCC i referuar në pikën 12 në Aneksin e Programit të Punës së UCC duhet të jetë pjesë e NIS. Zhvillimi dhe zbatimi i NIS përqendrohet kryesisht në opsionet e paraqitjes së deklaratave doganore, shkëmbinin e informacionit dhe zhvillimin e mesazheve (bazuar në aneksin B të UCC-së dhe Modelin e të Dhënave Doganore të BE-së - EUCDM) dhe ndikimin e ndryshmeve të kërkuara në sisteme të tjera elektronike në nivel kombëtar, siç janë TARIC, sistemi i menaxhimit të riskut, sistemet e kontabilitetit, sistemet e pagesave. NIS duhet gjithashtu të zbatojë thjeshtësimet e mundshme siç janë procedurat e thjeshtuara, hyrja në të dhënat e deklaruesit, zhodganimi i centralizuar në nivel kombëtar, etj. Lidhjet me sistemet dhe komponentët e tjerë doganorë janë renditur në fshën 1.23 të Aneksit 2 të MASP-C, rev.2023. Specifikimet funksionale dhe teknike për NIS janë nën përgjegjësinë e Shqipërisë. Është e rëndësishme të jani të vetëdijshëm se specifikimet funksionale dhe teknike të CCI-së (shih më sipër nën sistemet e decentralizuara, pika 3) të ofruara nga Komisioni mund të ripërdoren në një masë të madhe për zbatimin e NIS-së. Të gjitha Shtetet Anëtare ripërdorin specifikimet e përbashkëta të CCI-së për ndërtimin e NIS-it të tyre. Specifikimet e sistemit CCI të UCC-së janë hartuar për të mbuluar kërkesat e UCC-së në import, kur ato kombinohen me Autorizimin CCI në nivel BE-jë (përfshihen më shumë se një Shtet Anëtar). Ripërdorshmëria e proceseve dhe skenarëve dhe mesazheve përkatëse mund të jetë	I lartë	Sistemi ekzistues i importit do të përditësohet në UCC NIS gjatë fazës II të përditësimit të sistemit ASYCUDA.	Nevojitet përmirësimi i mëtejshëm i këtij sistemi, në mënyrë që të përmbushen plotësisht kërkesat e BE-së.	Në projektin "Përmirësimi i sistemit ASYCUDA. Sistemi Kombëtar i Importit (NIS) i UCC" pritet të tremujorin e 4-të të vitit 2028. Financimi do të sigurohet nga buxheti i shtetit.	Tremujori i dytë i vitit 2027 – Tremujori i katërt i vitit 2028. Rezultatet e para të preklime brenda 12 muajve nga lançimi i Fazës II	Grupi i punës i ngritur, Sektori për Procedurat Doganore	2.4 milion USD Faza II e përmirësimit të sistemit ASYCUDA	Buxheti Shtetit

Shtojca 2

Tabela e Kostimit të Strategjisë

Shtyllat

Nr.	Titulli	Plani i Veprimit 2025-2030 i Strategjisë	Kosto Totale Indikative		
			PBA	Financim nga Donatorët	Kosto totale
1	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 1:	Zhvillimi i një sistemi doganor dixhital, të integruar dhe koherent	374,000,000	-	374,000,000
2	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 2:	Modernizimi i administratës doganore dhe dixhitalizimi i proceseve të brendshme	-	240,471,600	240,471,600
3	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 3:	Mbështetja e dixhitalizimit të proceseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)	465,000,000	-	465,000,000
	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 4:	Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK në dogana	93,500,005	194,087,499	287,587,504
	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 5:	Përmirësimi i aftësive teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar	93,500,005	194,087,499	287,587,504
	Kostoja Indikative e Strategjisë		1,026,000,010	628,646,598	1,654,646,608



Komponentët

Plani i Veprimit i Strategjisë së sistemeve doganore, 2025-2030									
Qëllimi i Politikës (Shtylla) 1 : Zhvillimi i një sistemi doganor dixhital, të integruar dhe koherent									
Nr.	Titulli	Institucionet		Periodha e zbatimit		Kosto Totale Indikative (Leke)			
		Institucionet përgjegjëse	Institucionet kontribuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	PBA	Financim nga donatorët	Hendeku Financiar	Kosto totale
1.1	Objektivi Specifik (Komponenti) 1.1: Zhvillimi i një CDPS (Sistemi i Përpunimit të Vendimeve Doganore), të re shqiptare në përputhje me kërkesat e BE-së, që të mundësojë një mjedis doganor plotësisht elektronik dhe të integruar në nivel evropian.	MF, DPD	MF, DPD	2025	2030	93,500,000	0	0	93,500,000
	Objektivi Specifik (Komponenti) 1.2: Modernizimi i sistemeve të kontrollit doganor dhe menaxhimit të riskut, duke integruar mjetet e avancuara të analizës së të dhënave si dhe inteligjencës artificiale për të identifikuar dhe parandaluar riskun në kohë reale.					93,500,000	0	0	93,500,000
	Objektivi Specifik (Komponenti) 1.3: Optimizimi dhe dixhitalizimi i procedurave të veçanta (regjimet doganore të posaçme si përpunimi aktiv/pasiv, magazinimi doganor, njoftimi i mbërritjes dhe pranimit të magazinimit të përkohshëm, etj...), në linjë me standardet evropiane INF-STP dhe INF-SP, për t'i bërë ato më efikase dhe transparente.					93,500,000	0	0	93,500,000
	Objektivi Specifik (Komponenti) 1.4: Zhvillimi dhe përsosja e sistemit të akcizës, duke e integruar atë me sistemet doganore dhe tatimore për një administrim më të mirë të taksave indirekte dhe përputhshmëri me acquis-në e BE-së në fushën e akcizave.					93,500,000	0	0	93,500,000
	Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 1					374,000,000	-	-	374,000,000
Qëllimi i Politikës (Shtylla) 2: Modernizimi i administratës doganore dhe dixhitalizimi i proceseve të brendshme									
Nr.	Titulli	Institucionet		Periodha e zbatimit		Kosto Totale Indikative			
		Institucionet përgjegjëse	Institucionet kontribuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	PBA	Financim nga donatorët	Hendeku Financiar	Kosto totale
2.1	Objektivi Specifik (Komponenti) 2.1: Optimizimi dhe dixhitalizimi i plotë i procedurave doganore, duke krijuar module të posaçme elektronike për secilën procedurë (p.sh. tranziti elektronik, regjimet e përpunimit dhe magazinimit, etj.) në harmoni me sistemet evropiane.	MF, DPD	BB	2027	2030	-	240,471,600	-	240,471,600
	Objektivi Specifik (Komponenti) 2.2: Zbatimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të burimeve (fizike, TIK dhe njerëzore) për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës doganore, nëpërmjet investimeve strategjike, masave të avancuara për mbrojtjen e të dhënave, dhe mbështetjes dixhitale të të gjitha proceseve operacionale. Ky sistem do të garantojë që infrastruktura kritike (si pajisjet hardware, rrjetet, bazat e të dhënave dhe vetë strukturat organizative) të jetë e aftë t'u përgjigjet kërkesave në rritje dhe sfidave emergjente.	MF, DPD; AKSHI	AKSHI						
	Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 2					-	240,471,600	-	240,471,600



Qëllimi i Politikës (Shtylla) 3: Mbështetja e dixhitalizimit të proçeseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)									
Nr.	Titulli	Institucionet		Periudha e zbatimit		Kosto Totale Indikative			
		Institucionet përgjegjëse	Institucionet kontribuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	PBA	Financim nga donatorët	Hendeku Financiar	Kosto totale
1	Objektivi Specifik (Komponenti) 3.1.:Përmirësimi i shërbimeve elektronike doganore për komunitetin e biznesit, duke zgjeruar gamën dhe cilësinë e platformave dixhitale (portalet e biznesit dhe aplikacionet mobile, etj.) ku operatorët ekonomikë mund të kryejnë të gjitha formalitetet doganore pa pengesa.	MF, DPD; AKSHI	AKSHI	2025	2028	182,000,000	0	0	182,000,000
	Objektivi Specifik (Komponenti) 3.2.: Shfrytëzimi strategjik i burimeve për mirëmbajtjen dhe modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknologjike dhe asaj fizike, në mënyrë që sistemet doganore të jenë vazhdimisht të disponueshme, të sigurta dhe të përditësuara me teknologjinë më të re.	MF, DPD; AKSHI	AKSHI	2025	2028	184,000,000	0	0	184,000,000
	Objektivi Specifik (Komponenti) 3.3.: Ngritjen e një kapaciteti rezervë për rikuperimin e shpejtë të sistemeve dhe të dhënave në rast fatkeqësish ose emergjencash. Ky do të sigurojë që të dhënat konfidenciale doganore dhe biznesit të jenë të mbrojtura sipas standardeve më të larta dhe që operacionet doganore të mos ndërpriten edhe në rast të incidenteve madhore kibernetike apo fizike.	MF, DPD; AKSHI	AKSHI	2025	2028	99,000,000	0	0	99,000,000
	Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 3					465,000,000	-	-	465,000,000
Qëllimi i Politikës (Shtylla) 4: Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK në dogana									
Nr.	Titulli	Institucionet		Periudha e zbatimit		Kosto Totale Indikative			
		Institucionet përgjegjëse	Institucionet kontribuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	PBA	Financim nga donatorët	Hendeku Financiar	Kosto totale
	Objektivi Specifik (Komponenti) 4.1.: Zhvillimi dhe zbatimi i një kornize të plotë të arkitekturës për TIK në dogana, që përcakton standardet teknike, proçeset e menaxhimit të ndryshimit dhe kontrollit të cilësisë, dhe udhëzon integrimin e çdo sistemi të ri me infrastrukturën ekzistuese dhe sistemet e BE-së. Ky objektivi i veçantë siguron që transformimi dixhital të mbështetet nga një strategji e qëndrueshme dhe një strukturë qeverisjeje që garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave	MF, DPD	BB;BE	2026	2030	93,500,005	194,087,499	0	287,587,504
	Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 4					93,500,005	194,087,499	-	287,587,504
Qëllimi i Politikës (Shtylla) 5: Përmirësimi i aftësisë teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar									
Nr.	Titulli	Institucionet		Periudha e zbatimit		Kosto Totale Indikative			
		Institucionet përgjegjëse	Institucionet kontribuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	PBA	Financim nga donatorët	Hendeku Financiar	Kosto totale
	Objektivi Specifik (Komponenti) 5.1.: Sigurimi që punonjësit e administratës doganore të zotërojnë aftësitë e nevojshme në fushën e TIK, përmes trajnimeve sistematike dhe certifikimeve profesionale dhe njëkohësisht rritja e shkallës së mbajtjes së stafit të kualifikuar në TIK, falë krijimit të një mjedisi pune motivues, me kushte dhe paga konkurrense.	MF, DPD	BB;BE	2026	2030	93,500,005	194,087,499	0	287,587,504
	Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 5					93,500,005	194,087,499	-	287,587,504



publikë, vendës apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse.

g) urdhrin për kthimin apo moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe investimit;

h) urdhrin për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Besjan Kadiu, i ndjek dhe i zbaton ato në mbështetje të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ligjit nr. 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë urdhër.

3. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 121, datë 1.9.2025, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Besjan Kadiu, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belina Balluku

URDHËR
Nr. 1245, datë 21.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
Pays de la Loire	Maine-et-Loire	Cholet*
Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
Auvergne-Rhône-Alpes	Loire	Montbrison*
Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Beaune*
Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Dijon*
Grand Est	Marne	Vitry-le-François*
Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Nantes*
Pays de la Loire	Vendée	Les Sables-d'Olonne*
Pays de la Loire	Vendée	La Roche-sur-Yon*
Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Bressuire*
Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Périgueux*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të